

KATALOGIMI I MONOGRAFIVE – PYETJET MË TË SHPESHTA DHE TË REJAT

Që nga viti 2002 në NUK (Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Sllovenisë), regjistrimet bibliografike kohë pas kohe kontrollohen. Me fillimin e kontrollit të njësuar, kontrollohen edhe regjistrimet e njësuara. Qëllimi është të shihet se sa mirë kataloguesit i njohin rregullat e katalogimit dhe në çfarë duhet të jemi të kujdesshëm gjatë kualifikimit të kataloguesve të rinj¹.

Për shkak se pasaktësitë në regjistrime përsëriten, në bazë të gabimeve dhe pyetjeve më të shpeshta të kataloguesve, të cilët katalogojnë rregullisht ose kohë pas kohe, si dhe të punonjësve të bibliotekave që krijojnë regjistrimet testuese, janë përgatitur disa udhëzime të shkurtëra për katalogim, ndërsa në dokument janë përfshirë edhe të rejat apo përditësimet e rregullave të katalogimit².

Udhëzime të shkurtëra për katalogimin e monografive

Burimi i të dhënave

Burimet e të dhënave për zonat e caktuara të ISBD(M)-së:

- 1. zona e titullit dhe të dhënat për përgjegjësinë (fusha 200)** – faqja e titullit (ose ato zëvendësuese)
- 2. zona e botimit (fusha 205)** – faqja e titullit (ose ato zëvendësuese), faqet e tjera të fillimit, kolofoni
- 3. zona e botuesit/shpërndarësit (fusha 210)** – faqja e titullit (ose ato zëvendësuese), faqet e tjera të fillimit, kolofoni
- 4. zona e përshkrimit fizik (fusha 215)** – botimi në tërësi
- 5. zona e serisë (fusha 225)** – faqja e titullit (ose ato zëvendësuese), faqet e tjera të fillimit, kolofoni, kapaku, shpina e librit
- 6. zona e shënimeve (blloku 3XX)** – çdo burim i të dhënave
- 7. zona e numrave standardë (fusha 010)** - çdo burim i të dhënave

Të dhënat, të cilat i gjeni jashtë burimit që katalogoni, në zonat e caktuara duhet t'i vendosni në kllapa të rrumbullakëta (blloku 2XX), ose pa kllapa i vendosni tek shënimet (blloku 3XX).

Të dhënat për përshkrimin e njësisë mund t'i merrni edhe nga CIP-i, kur nuk ndodhen askund tjetër ose në të janë më të plota. CIP vlenë si burim i të dhënave për zonën 3, 4, 6, 7 dhe 8. Kur të dhënat i

¹ Për krijimin e regjistrimeve bibliografike dhe atyre të njësuara në Slloveni përdoret **PPIAK** (Eva Verona: Pravidnik i priručnik za izradbu abecednih kataloga), standardi **ISBD** dhe formati **COMARC**.

² Pas vendimit për fillimin e përdorimit të standardit RDA, përditësimi i rregullave të katalogimit bëhet në përputhje me këtë standard. (RDA: Resource description and access është standard ndërkombëtar për katalogim, i krijuar për mjedisin digjital.)

përdorni për zonën 1 ose 2, tek shënimet duhet të shpjegoni burimin e të dhënave (p.sh. *Përkthyesi ndodhet në CIP, E dhëna për botimin ndodhet në CIP*). Kur të dhënat në CIP ndryshojnë nga të dhënat në burimin tjetër, ato mund t'i vendosni në zonën e shënimeve.

Të dhënat nga mbështjellësi i njësisë nuk vendosen në regjistrim (përveç në shënime).

Përshkrimi i të dhënave

(gjuha e përshkrimit, shkronjat e mëdha, shkurtesat)

Përshkrimi bibliografik bëhet për të identifikuar botimin, për këtë arsye shumica e të dhënave shënohen në gjuhën e botimit. Vetëm në zonën 5 (përshkrimi fizik – fusha 215) dhe në zonën 7 (shënimet – blloku 3XX) përdoret gjuha e katalogimit. Hapësirat përdoren në përputhje me rregullat e drejtshkrimit, p.sh. pas pikës dhe presjes gjithmonë vendoset hapësirë. Në vend të të dhënave në zonën e përgjegjësisë (nënfushat 200f dhe 200g), të cilat për arsye të ndryshme nuk dëshironi t'i shënoni, duhet të vendosni tri pika, ndërsa para dhe pas tyre vendoset hapësirë (p.sh. autori i parë ... [et al.]).

Gabimet e shtypit shënohen ashtu siç paraqiten në njësi, ndërsa pas fjalëve të shtypura gabimisht vendoset pikëquditëse ose shkurtesa sic në kllapa katrore ([!]) ose [sic]), para kllapave vendoset hapësirë (p.sh. *ilutroi [!] Artë Nitaj*). Fjalën e shtypur gabim mund ta shënoni të përmirësuar brenda kllapave katrore, mirëpo para përmirësimit duhet të vendosni shkurtesën **i. e.**

Përdorimi i shkronjave të mëdha duhet të bëhet në përputhje me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në të cilën është njësia. Shkronjat e mëdha janë të detyrueshme në fillim të çdo zone të ISBD-së (apo në fillim të fushave përkatëse në formatin COMARC). Titujt paralel dhe titujt e pjesëve gjithmonë shënohen me shkronjë të madhe, ndërsa informacionet e tjera për titullin (nëntitujt) zakonisht shënohet me shkronjë të vogël apo në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

Tek titujt në gjuhën angleze shpesh shkronjat e mëdha përdoren tek çdo fjalë, përveç tek parafjalët dhe nyjet, mirëpo ju duhet t'i përmbaheni rregullave të drejtshkrimit të gjuhës angleze (me shkronjë të madhe shënohet vetëm fjala e parë dhe fjalët, të cilat sipas rregullave të drejtshkrimit shënohen me shkronjë të madhe, p.sh. gjuhët dhe kombësitë (English, German etj.), ditët dhe muajt (Monday, February etj.)). Këto rregulla vlejnë edhe për informacionet e tjera për titullin, variantet e tjera të titullit dhe për titullin e serisë.

Në emrat e organizatave (këtu bëjnë pjesë edhe emrat e botuesve) dhe të mbledhjeve (konferencave etj.) në gjuhën angleze, të gjitha fjalët, përveç parafjalëve, nyjeve dhe lidhëzave, shënohen me shkronja të mëdha (pavarësisht se në cilën pjesë të përshkrimit bibliografik paraqiten), p.sh. *Oxford University Press* etj.

Sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës gjermane të gjithë emrat shënohen me shkronjë të madhe.

Për disa të dhëna përdoren shkurtesat e standardizuara (bot., vëll., f., me il. etj.) Shkurtesat mund të shënohen edhe me shkronja të mëdha edhe me shkronja të vogla, varësisht se kujt i përket ajo (p.sh. shkurtesa për numrin e pjesës në nënfushën 200h shënohet me shkronjë të madhe, ndërsa shkurtesa për numrin e pjesës në nënfushën 225v shënohet me shkronjë të vogël apo në përputhje me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës së njësisë).

BLLOKU 0XX

Fusha 010 Numri standard ndërkombëtar i librit (ISBN)

Nënfusha 010a

Grupet e veçanta të numrave në ISBN mes vete ndahen me viza, edhe nëse ato nuk ndodhen në botim. Kur viza në numrin e ISBN-së është në vendin e gabuar, nuk bëhet fjalë për numër të gabuar dhe forma me vendosjen e gabuar të vizave nuk vendoset në nënfushën 010z (numri me vendosjen e saktë të vizave vendoset në nënfushën 010a).

Nënfusha 010b

Kur botimi ka disa numra të ISBN-së (për çdo numër të ISBN-së përsëritet fusha 010) ose kur ajo është botuar nga disa botues, në nënfushën 010b vendoset shpjegimi përkatës. Nëse botimi ka një numër të ISBN-së dhe nëse është vetëm një botues, shpjegimi nuk është i nevojshëm. Shpjegimi për burimin e numrit të ISBN-së nuk vendoset në asnjë rast. Gjithashtu nuk vendosen shpjegimet të numrat 10 shifror dhe 13 shifror të ISBN-së (shpjegimi i tillë është vendosur vetëm një kohë të shkurtër, kur ka hyrë në përdorim numri 13 shifror).

Shpjegimi zakonisht bëhet në gjuhën e institucionit katalogues, ndërsa për llojet e ndryshme të lidhjeve mund të vendosen termat standardë ose shkurtesat nga botimi.

Disa numra të ISBN ekzistojnë tek këto raste:

- botimi ka disa botues (te çdo numër i ISBN-së vendoset emri i botuesit si shpjegim),
- botimi është shtypur në lidhje të ndryshme
- botimi ka disa vëllime. Numrin e saj të ISBN-së mund ta ketë botimi në tërësi (kompleti), por edhe vëllimet e veçanta; përdoret shkurtesa vëll., e cila nuk vendoset brenda shenjave për klasifikim (p.sh. *vëll. 3*).

Nënfusha 010z

Nëse në botim është numri i gabuar i ISBN-së, ai për shkak të kërkimit vendoset në nënfushën 010z (përdoruesi nuk mund ta di që ISBN është e gabuar).

BLLOKU 1XX

Fusha 100 Të dhënat e përgjithshme për materialin

Viti apo vitet dhe kodi për vitin e botimit në nënfushat 100bcd duhet të përputhen me të dhënë në nënfushën 210d.

Nënfusha 100b

Te monografitë e përfunduara në një ose në disa vëllime, që kanë dalë brenda një viti kalendarik, përdoret kodi "d" (viti i botimit dihet dhe nuk ka dyshime). Kodi "d" vendoset edhe në rastin kur në nënfushën 210d viti ndodhet brenda kllapave katrore (prezenca e kllapave katrore nuk do të thotë se viti nuk është i sigurt, mirëpo tregon se viti i botimit nuk është gjetur në burimin kryesor të të dhënave, por p.sh. në kapak ose është gjetur në një vend apo formë tjetër) si dhe në rastin kur në nënfushën 210d ndodhet viti i mundshëm i botimit (p.sh. [2003?]).

Kur në botim nuk ndodhet viti i botimit apo i shtypjes, mirëpo vetëm viti i së drejtës së autorit (copyright), vendoset kodi "h". Në nënfushën 210d, para vitit duhet të vendoset shkurtesa cop. (p.sh. *cop. 2004*).

Kur viti i botimit nuk është i sigurt, përdoret kodi "f". Në nënfushën 100c vendoset viti më i hershëm i mundshëm, ndërsa në nënfushën 100d viti më i ri i mundshëm i botimit. Viti i botimit në nënfushën 210d vendoset bashkë me shpjegimin përkatës (p.sh. [midis v. 1930 dhe 1940], [rreth v. 1950]).

Te riprodhimi i dokumentit (faksimilet, botimet speciale etj.) përdoret kodi "e". Në nënfushën 100c vendoset viti i botimit i njësisë që katalogohet, ndërsa në nënfushën 100d viti i origjinalit.

Te katalogimi i botimeve në disa vëllime, të cilat botohen (ose janë botuar) më shumë se një vit kalendarik, përdoret kodi "g". Në nënfushën 100c vendoset viti i botimit i vëllimit të parë, ndërsa në nënfushën 100d viti i botimit i vëllimit të fundit.

Nënfusha 100c

Në këtë nënfushë vendoset viti i botimit i njësisë që ka dalë brenda një viti kalendarik (te vitet e pasigurta vendoset viti më i hershëm).

Nënfusha 100d

Për njësitë, viti i botimit i të cilave nuk është i sigurt (në nënfushën 100b është kodi "f") në nënfushën 100d vendoset viti më i ri i mundshëm i botimit. Te riprodhimet (në nënfushën 100b është kodi "e") vendoset viti i botimit i origjinalit. Te botimet e papërfunduara (në nënfushën 100b është kodi "g") vendoset viti i botimit të vëllimit të dytë apo të fundit (te katalogimi i vëllimit të parë në nënfushën 100d vendoset 9999). Në nënfushën 100d vendoset edhe viti i gabuar i botimit.

Nënfusha 100g, 100i dhe 100l

Kur katalogoni një botim në shkrim jolatin, në nënfushën 100g duhet patjetër të vendoset kodi i regjistrimit të modifikuar ("1"), në nënfushën 100i kodi "b" (transliterime të tjera), ndërsa në nënfushën 100l kodohet lloji i shkrimit jolatin sipas listës së kodeve. Llojet e shkrimeve jolatine vendosen edhe në shënime, në fushën 300 (p.sh. *Cir.*).

Fusha 101 Gjuha e njësisë

Nënfusha 101a

Në nënfushën 101a kodohet gjuha e tekstit. Kur bëhet fjalë për tekst origjinal, vlera e treguesit është "0". Kur teksti është në disa gjuhë dhe nuk bëhet fjalë për përkthime, për çdo gjuhë përsëritet nënfusha 101a, edhe atëherë kur vlera e treguesit është "0". Kur botimi përmban përkthime, për çdo gjuhë përsëritet nënfusha 101a, ndërsa vlera e treguesit është "2". Në regjistrimet për botimet në disa gjuhë kodet e gjuhës në nënfushën 101a duhet të përputhen me shënimet për gjuhën në fushën 300.

Te përmbledhjet e punimeve tekstet kryesore të botimit janë abstraktet (përmbledhjet), për këtë arsye ato kodohen në nënfushën 101a, ndërsa shënimi për gjuhën bëhet në fushën 300.

Nënfusha 101b

Kur vepra nuk është përkthyer nga origjinali, gjuha e tekstit të ndërmjetëm kodohet në nënfushën 101b. E dhëna duhet të harmonizohet me shënimin për gjuhën në fushën 300.

Nënfusha 101c

Kur botimi është përkthim, në nënfushën 101c kodohet gjuha e veprës origjinale, ndërsa vlera e treguesit të parë është "1". Nënfusha 101c plotësohet edhe në rastet kur botimi përmban tekstin origjinal dhe përkthimin/et e tij dhe gjuha e veprës origjinale dihet, ndërsa vlera e treguesit të parë është "2". (Kur botimi nuk është përkthim ose kur botimi nuk përmban përkthime, nënfusha 101c nuk plotësohet).

Nënfusha 101d

Në nënfushën 101d kodohet gjuha e përmbledhjes (abstraktit). Kur botimi përmban përmbledhje (abstrakte) në disa gjuhë, nënfusha 101d përsëritet. Gjuha e përmbledhjes (abstraktit) nuk ndikon në vlerën e treguesit. Kodi (kodet) për gjuhën e përmbledhjes (abstraktit) duhet të jetë në harmoni me shënimin për përmbledhjen (abstraktin) në fushën 320. Gjuha e përmbledhjes (abstraktit) kodohet (dhe për të bëhet shënim në fushën 320) edhe kur nuk ndryshon nga gjuha e tekstit kryesor të njësisë.

Nënfusha 101f

Kur gjuha e faqes së titullit ndryshon nga gjuha e tekstit të njësisë, ajo kodohet në mënyrë të veçantë në nënfushën 101f.

Fusha 102 Shteti botimit ose prodhimit

Kur njësia botohet në disa shtete, në nënfushat e përsëritshme 102a kodohen më së shumti tri shtete. Kodimi duhet të bëhet në harmoni me të dhënat në fushën 210 (p.sh. nëse në fushën 210 janë vendosur tri vende të shteteve të ndryshme, në fushën 102 duhet të kodohen të trija shtetet; nëse njësia është botuar në më shumë se tri vende, në nënfushën 210a vendoset vendi i parë dhe shkurtesa [etc.], ndërsa në fushën 102 kodohet vetëm shteti i parë).

Fusha 105 Materiali tekst monografik

Nënfusha 105a (kodet për ilustrimet)

Kodimi i ilustrimeve duhet të bëhet në harmoni me të dhënat në nënfushën 215c. Kur njësia përmban shtojca (fletë me ilustrime dhe me tekst përcjellës apo pa të, të cilat nuk janë të përfshira në numërtimin kryesor të faqeve ose fletëve), e dhëna e koduar në nënfushën 105 duhet të jetë në harmoni me të dhënë në nënfushën 215.

Për grafikët, tabelat dhe fotografitë përdoret kodi "a".

Nënfusha 105b (kodet për llojin e përmbajtjes)

Zakonisht kodet harmonizohen me të dhënat për përmbajtjen në bllokun 6XX.

Nënfusha 105e (e dhëna për indeksin)

Kodimi i indekseve duhet të harmonizohet me të dhënë në fushën 320 (kur në njësi është indeksi i emrave etj., në nënfushën 105 e vendoset kodi "1").

Nënfushat 105cdfg

Kur kodet i përshtaten llojit të botimit, përdoret nënfusha 105c (për botimet nga konferenca), 105d (për botimet përkujtime), 105f (për letërsinë) dhe 105g (për biografinë).

BLLOKU 2XX

Në përshkrimin bibliografik të gjitha nyjet e përparme, të shquara apo të pashquara, të elementeve për kërkim (titulli/titujt, emri i botuesit, titulli i serisë etj.), për shkak të klasifikimit të saktë vendosen brenda shenjave për klasifikim (‡). Shenja është ngjitur me fjalën në vazhdim, midis fjalëve të veçanta ka hapësirë (p.sh. ‡*Der Arbeiter*). Nyja L' shënohet me shenjat për përjashtimin e klasifikimit pa hapësira (p.sh. ‡*L'Amour*). Midis shenjave për klasifikim vendosen edhe termat e përgjithshëm për serinë, nënserinë etj. si dhe shkurtesat për vëllimet (p.sh. vëll., nr., vol., no., zv., Bd. etj.) në nënfushat 200h, 225ahiv.

Elementet e përshkrimit bibliografik brenda një zone, që nuk ndodhen në burimin kryesor të të dhënave dhe duhet të vendosen në kllapa katrore, vendosen në kllapa katrore të veçanta. Kllapat katrore përdoren veç e veç (të veçanta) në këto raste:

- në zonën e titullit dhe përgjegjësisë (fusha 200), ku një kllapë hapet dhe mbyllet në zonën e titullit, ndërsa tjetra në zonën e përgjegjësisë (p.sh. **200a***Në stuhi e [poezi të zgjedhura] f [shkroi Janez Novak g ilustroi Mojca Dolzan]*);
- në zonën e botuesit (fusha 210), ku të dhënat për vendin e shtypjes (prodhimit) dhe të shtypshkronjës (prodhuesit) vendosen në kllapa të veçanta katrore (p.sh. **210a***Tiranë c Toena d [1999] e [Tiranë g Infograf]*).

Fusha 200 Titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë

Renditja e nënfushave

Renditja e nënfushave është e rëndësishme për shkak të shfaqjes së saktë të regjistrimit.

Titulli i përbashkët vendoset në nënfushën 200a, numri i pjesës në nënfushën 200h, ndërsa titulli i pjesës në nënfushën 200i. Vazhdon përgjegjësia parësore në nënfushën 200f dhe më pas përgjegjësitë e tjera në nënfushat e përsëritshme 200g.

Titulli paralel vendoset në nënfushën 200d dhe zakonisht vjen pas titullit kryesor në nënfushën 200a. Informacioni tjetër për titullin (nëntitulli) mund të vije pas titullit kryesor në 200a, titullit të pjesës në 200i ose titullit paralel në 200d (varësisht nga fakti se cilit titull i përket informacioni për titullin).

Titulli i pjesës në gjuhën tjetër nuk vendoset në nënfushën 200d, mirëpo ai vendoset në 200i (kur është e nevojshme, për shkak të shfaqjes së saktë, para titullit vendoset shenja e barazimit).

Kur në burimin e të dhënave është një ose disa tituj paralel dhe disa informacione të tjera për titullin (nëntituj), çdo informacion tjetër për titullin (nëntitull) vendoset pas titullit me të cilin është i lidhur në aspektin gjuhësor (krijohet blloku gjuhësor – nënfushat 200aede). Kur numri i titujve paralel dhe numri i informacioneve të tjera për titullin (nëntitujve) nuk përputhen, informacionet e tjera për titullin vendosen pas titullit të fundit paralel (nënfushat 20adde).

Kur në burimin e të dhënave titujt dhe informacionet e tjera për titullin (nëntitujt) janë në disa gjuhë, si dhe të dhënat për përgjegjësinë janë në disa gjuhë, çdo e dhënë për përgjegjësinë vije pas titullit ose informacionit tjetër për titullin (nëntitullit), me të cilin është i lidhur në aspektin gjuhësor (blloku gjuhësor).

- 200 1_ aMenaxhimi i ndryshimeve
epërmbledhje e abstrakteve të Konferencës së 25-të Ndërkombëtare për
Zhvillimin e Shkencave Organizative
eKosovë, Prishtinë, 15-17 mars 2006
f[këshilli redaktues Dritan Hasko ... et al.]
dChange management
ebook of abstracts of the 25th International Conference on Organizational
Science Development
eKosovo, Prishtina, March 15th-17th, 2006
f[editorial committee Dritan Hasko ... et al.]

Kur numri i titujve, informacioneve të tjera për titullin (nëntitujve) dhe të dhënave për përgjegjësinë nuk përputhen, nuk mund të krijohet blloku gjuhësor (kur është e nevojshme, për shkak të shfaqjes së saktë, para informacionit tjetër për titullin (nëntitullit) apo përgjegjësisë vendoset shenja e barazimit).

Titulli i saktë (kryesor), titulli paralel, titulli i pjesës dhe informacioni tjetër për titullin (nëntitulli)

Titulli i saktë (kryesor) vendoset në nënfushën 200a, titulli paralel në nënfushën 200d, titulli i pjesës në nënfushën 200i, ndërsa informacioni tjetër për titullin (nëntitulli) në nënfushën 200e.

Kur vepra ka autor dhe përshkrimi bëhet me autor, domethënë pikëqasja është autori, vlera e treguesit të parë është "0", ndërsa kur përshkrimi bëhet me titull, domethënë pikëqasja është titulli, vlera e treguesit të parë është "1". Kur fillimi i titullit është i njëjtë me pikëqasjen (emrin e personit ose organizatës), vlera e treguesit të parë është "0".

Titujt dhe informacionet e tjera për titujt (nëntitujt) përshkruhen fjalë për fjalë nga faqja e titullit apo nga burimi i të dhënave (së bashku me gabimet e shtypit); shkronjat e mëdha dhe shenjat e pikësimit shënohen në përputhje me rregullat e drejtshkrimit të gjuhës në të cilën është njësia. Kur në titull apo në informacionin tjetër për titullin (nëntitullin) ndodhen tri pika (...), ato në përputhje me rregullat e katalogimit shndërrohen në tri viza (---). Shenja lidhëse (&) gjithmon shënohet ashtu siç është në njësi.

Kur vitet, që tregojnë periudhë kohore (p.sh. 1984-2004), në njësi janë të ndara në mënyrë grafike nga titulli kryesor, ato vendosen si informacion tjetër për titullin (nëntitull) në nënfushën 200e.

Titulli paralel është titulli në gjuhën tjetër. Në nënfushën 200d vendoset vetëm atëherë kur ai ndodhet në faqen e titullit. Titujt në gjuhë të tjera, që nuk ndodhen në faqen e titullit, vendosen në zonën e shënimeve në fushën 300 bashkë me frazat e dhura hyrëse dhe si element për kërkim vendosen edhe në fushat përkatëse në bllokun 5XX.

Përsëritja e nënfushave 200i domethënë hierarki e titujve të pjesëve. Kur titujt e pjesëve mes tyre janë të barazvlershëm, ata nuk vendosen në nënfushat e përsëritshme 200i, mirëpo në shënimet për përmbajtjen në fushën 327.

E dhëna për numrin e pjesës në nënfushën 200h shënohet me shkronjë të madhe dhe vendoset brenda shenjave për klasifikim. Numërtimi gjithmonë bëhet me numra arab, përdoren shkurtesat e standardizuara (*≠Vëll. ≠2, ≠Vol. ≠3* etj).

Kur titujt apo informacionet e tjera për titujt (nëntitujt) në fushën 200 vendosen në kllapa katrore (sepse në njësi nuk ndodhen brenda burimit të të dhënave: faqja e titullit ose faqja e titullit zëvendësuese), burimi i këtyre të dhënave shpjegohet në shënime në fushën 300.

Të dhënat për përgjegjësinë

Të dhënat për përgjegjësinë vendosen në gjuhën e botimit, ashtu siç janë në njësi, mirëpo nuk vendosen dy pikat dhe titujt akademik. Autorësitë e llojit të njëjtë (disa autorë parësor, disa përkthyes, ilustrues) mes tyre ndahen me presje, edhe nëse në njësi ndodhet ndonjë shenjë tjetër (vizë e pjerrët, vizë). Lidhëzën midis dy emrave e shënojmë ashtu siç është në botim (p.sh. *autorë Arta Veliu, Berat Buzhala, apo ilustruan Venera Hajdari, Din Jakupi dhe Enisa Zeka, apo Marko & Mirela Kruja* etj.). Fillimisht shënohen të dhënat për përgjegjësinë nga faqja e titullit, pastaj të dhënat nga burimet e tjera.

Emri i organizatave me funksionin e njëjtë (p.sh. orgaizatorët e mbledhjes) lidhen mes vete me lidhëz. Nëse lidhëza nuk ndodhet në njësi, ajo vendoset në kllapa katrore (në gjuhën e njësisë), p.sh. *organizuan Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë [dhe] Biblioteka e Universitetit të Mjekësisë*. Presja

përdoret për të ndarë institucionet kryesore nga ato të varura (p.sh. *përgatiti Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë*).

Brenda një përgjegjësie të njëjtë vendosen më së shumti tre autorë vetjakë ose tri organizata. Kur janë më shumë se tre autorë, shënohet autori i parë, pastaj tri pika dhe shkurtesa et al. në kllapa katrore (*[et al.]*). Shkurtesat nuk vendosen në kllapa të veçanta katrore, nëse në këtë rast e dhëna do të përfundonte me dy kllapa (p.sh. *[ilustroi Jernej Benko ... et al.]*).

Nëse përshkrimi bëhet me titull, mirëpo njësia është përgatitur nga organizata (njësia është vepër e disa autorëve, emrat e të cilëve nuk dihen), organizata vendoset si përgjegjësi në nënfushën 200f, në kllapa katrore vendoset shpjegimi për funksionin e organizatës në gjuhën në të cilën është njësia (p.sh. *[përgatiti] Biblioteka Kombëtare dhe Universitare* apo *[prepared by] National and University Library*).

Te autorët dytësorë përkrah emrit të autorit gjithmonë vendoset edhe shpjegimi për llojin e autorësisë. Kur në botim nuk ndodhet lloji i autorësisë, atë e vendos kataloguesi në kllapa katrore (p.sh. *[ilustroi] Majlinda Krenzi* ose *[organizator] Shoqata e Ekonomistëve të Prishtinës*). (Autorët parësorë zakonisht vendosen në nënfushën 200f dhe në këtë rast lloji i autorësisë nuk vendoset, vetëm nëse kjo e dhënë ndodhet në burimin e të dhënave për autorësinë (dhomethënë në faqen e titullit), p.sh. *autor Andi Laho*.)

Kur e dhëna për përgjegjësinë është në dy ose më shumë gjuhë (p.sh. emri i konferencës, organizatori etj.), të dhënat e veçanta shënohen në nënfushat e ndara **f** ose **g**. Në nënfushën e përsëritshme, para të dhënës për përgjegjësinë në gjuhën tjetër është shenja e barazimit, e pas saj hapësirë (=):

200 1_ forganizoi Shoqëria e Inxhinierisë së Ndriçimit të Kosovës
f= [organized by] Lighting Engineering Society of Kosovo
g[redaktor i përmbledhjes Adrian Hoxha]

Kur në faqen e titullit emri i autorit është vetëm njëherë, ndërsa lloji i përgjegjësisë është në disa gjuhë, e dhëna përshkruhet ashtu siç është në njësi. Të dhënat mes tyre ndahen me presje (edhe nëse në botim është viza e pjerrët ose ndonjë shenjë tjetër), p.sh. *autor, author Fatmir Xhema*. Kur të dhënat për llojin e përgjegjësisë në disa gjuhë ndodhen në kolofon, në kapak ose në faqet e fillimit, llojin e përgjegjësisë mund ta shënoni vetëm në gjuhën e titullit apo njësisë.

Kur në faqen e titullit emri i autorit shfaqet vetëm si pjesë e titullit ose si pjesë e informacionit tjetër për titullin (nëntitullit), ai nuk vendoset në zonën e përgjegjësisë, edhe pse emri shfaqet në kolofon ose në kapak (p.sh. *Poezitë e Ali Hadrit*). Në zonën e përgjegjësisë emri i autorit vendoset vetëm kur kur ai shfaqet edhe në faqen e titullit.

Kur në zonën e përgjegjësisë vendoset redaktori i botimit, atëherë kryeradaktori ose bordi redaktues nuk vendosen.

Emri i prodhuesit si përgjegjësi vendoset vetëm kur ai ndodhet në faqen e titullit apo në burimin kryesor të të dhënave (ose kur e dhëna për prodhuesin është e vetmja e dhënë për përgjegjësinë) dhe nuk është në të njëjtën kohë edhe botues (në fushën 712 ai nuk vendoset).

Në fushën 200 nuk vendosen këshilluesit (mentorët) e disertacioneve, tezave të masterit apo temave të diplomës (si element për kërkim ai vendoset në fushën 702, dhe tek shënimet në fushën 314). Nuk vendosen autorët apo organizatorët e ekspozitave (përshkruhet vetëm katalogu), bordi organizativ (përshkruhet përmbledhja e punimeve), sponsorët, lektorët, recensuesit, bashkëpunëtorët profesionalë, redaktuesit teknikë etj. Gjithashtu nuk i përkasin zonës së përgjegjësisë të dhënave që kanë të bëjnë me dizajnin dhe pamjen e kapakut apo mbështjellësit të njësisë (dizajnesit, autorët e fotografive ose ilustrimeve në kapak).

Kur autori parësor (deri në tre persona ose organizata) nuk ndodhet në burimin kryesor të të dhënave (në faqen e titullit), ai duhet të vendoset në kllapa katrore. Në shënime në fushën 300 shpjegohet se në cilën pjesë të njësisë është gjetur e dhëna për autorin. (Në shënime nuk bëhet shënim për burimin e të dhënave për autorët dytësorë, përveç kur e dhëna ndodhet vetëm në CIP.)

Disa vepra të një autori

Kur njësia përmban dy ose disa vepra të autorit të njëjtë dhe nuk ka titull të përbashkët (titujt e veprave të veçanta ndodhen në faqen e titullit), secili titull vendoset në nënfushën e tij 200a (p.sh. **200a***Fëmijët pa kufij* **a***E dua jetën* **f***Mirlinda Beqiri*)

Kur njësia përmban dy ose disa vepra të autorit të njëjtë dhe ka titullin e përbashkët (titujt e veprave të veçanta ndodhen në faqen e titullit), në nënfushën 200a vendoset titulli i përbashkët, ndërsa titujt e veprave të veçanta vendosen në shënimet për përmbajtjen në fushën 327 (p.sh. **200a***Tri drama* **f***Elona Neziri* **3270***Përmbajtja në faqen e tit.: a**Hakmarrja e Elektrës* **a***Magjistraja* **a***Udhëtarët*). Titujt e veçantë vendosen edhe në fushën 423 (për shkak të mundësisë për kërkim). Kur titujt e veprave të veçanta nuk ndodhen në faqen e titullit, kataloguesi vendos vet nëse shënimi i tyre në regjistrim është në interes të përdoruesve të katalogut apo jo (zakonisht titujt e veprave të veçanta vendosen kur titulli i përbashkët është një term i përgjithshëm). Nëse titujt e veprave të veçanta vendosen në fushën 327, ato duhet të vendosen edhe në fushën 423 (për shkak të kërkimit).

Kur botimi përmban dy ose disa vepra të autorit të njëjtë, por në faqen e titullit ndodhet vetëm titulli i veprës së parë, titulli(jt) i veprës së dytë (veprave të tjera) vendoset në shënimet për përmbajtjen në fushën 327 (p.sh. **200a***Teksti i rapsodive* **f***Miro Dakaj* **3270***Përmban edhe: al**mprovizimi në temën e panjohur*). Titulli(jt) e veprës së fshehur (veprave të fshehura) vendoset edhe në fushën 423.

Disa vepra të disa autorëve

Kur njësia përmban vepra të dy ose disa autorëve të ndryshëm dhe nuk ka titull të përbashkët (titujt e veprave të veçanta nuk ndodhen në faqen e titullit), titulli i veprës së autorit të dytë (apo titujt e veprave të autorëve të tjerë) vendoset në nënfushën 200c. Pas titullit vendoset autorësia përkatëse (p.sh. **200a***Algjebra lineare* **f***Zekë Binaj* **c***Programimi linear* **f***Ben Apolloni*). Titulli i veprës së dytë të autorit të njëjtë vendoset në nënfushën 200a (renditja e nënfushave mund të jetë kështu: 200afcf, 200aafcf etj.). Titujt e veçantë, të cilët nuk janë vendosur në nënfushën e parë 200a, duhet të vendosen edhe në fushën 423.

Kur botimi përmban veprat e veçanta të dy apo disa autorëve të ndryshëm dhe ka titullin e përbashkët (titujt e veprave të veçanta janë në faqen e titullit), në nënfushën 200a vendoset titulli i përbashkët (përshkrimi bëhet me titull, vlera e treguesit të parë është "1"), ndërsa titujt dhe autorët e veprave të veçanta vendosen në shënimet për përmbajtjen në fushën 327 (p.sh. **200aGjithësia 3270Përmbajtja në faqen e tit.: aRrugëtimi në gjithësia / Vlora Gashi. 700000 kilometra në gjithësi / Besjan Hasani**). Titujt e veçantë vendosen edhe në fushën 423, për shkak të kërkimit. Kur titujt e veprave të veçanta nuk ndodhen në faqen e titullit, kataloguesi vendos vet nëse shënimi i tyre në regjistrim është në interes të përdoruesve të katalogut apo jo (zakonisht titujt e veprave të veçanta vendosen kur titulli i përbashkët është një term i përgjithshëm). Nëse titujt e veprave të veçanta vendosen në fushën 327, ato duhet të vendosen edhe në fushën 423.

Kur botimi përmban dy ose disa vepra të dy ose disa autorëve, ndërsa në faqen e titullit ndodhet vetëm vepra e autorit të parë (mund të jenë disa vepra të autorit të parë), titulli (titujt) i veprës së fshehur (veprave të fshehura) vendoset në shënimet për përmbajtjen në fushën 327 dhe në fushën 423 (për shkak të kërkimit dhe përshkrimit të detyrueshëm shtesë).

Botimet e mbledhjeve (konferencave etj.)

Të dhënat për mbledhjet në përshkrimin bibliografik vendosen si titull ose informacion tjetër për titullin (nëntitull)³. Tek të dhënat për përgjegjësinë vendosen vetëm personat dhe shoqatat (organizatat, institucionet, shoqëritë etj.) që kanë bashkëpunuar në krijimin e burimit bibliografik.

Kur në burimin kryesor të të dhënave është e dhëna për mbledhjen ose për temën, kjo e dhënë përzgjidhet për titull.

Kur në burimin kryesor të të dhënave është edhe e dhëna për mbledhjen edhe ajo për temën, për titull përzgjidhet njëra nga ato. Përparësi ka e dhëna, e cila grafiksht është më e theksuar. Nëse asnjëra nga këto të dhëna nuk është grafiksht e theksuar, për titull përzgjidhet e dhëna e parë, ndërsa tjetra vendoset si informacion tjetër për titullin.

Informacionet e tjera për titullin (nëntitujt) vendosen sipas renditjes që është në njësi (ose në një renditje tjetër logjike)⁴.

Data dhe vendi i mbledhjes, të cilat në njësi nuk janë të lidhura me të dhënat e tjera, në përshkrimin bibliografik vendosen si informacion tjetër i pavarur për titullin.

Shembuj

200 0_ aDita e verës 2012

eTiranë, 28 nëntor 2012

f[organizator Instituti Bujqësor i Shqipërisë

gredaktor Fatos Muja]

(Në faqen e titullit është vetëm e dhëna për mbledhjen (emri i mbledhjes është i theksuar në mënyrë grafike, nën të janë

³ Deri në mars të vitit 2020 në Slloveni emri i mbledhjes (konferencës) është vendosur si titull kryesor në nënfushën 200a vetëm kur në burimin e të dhënave nuk ka qenë ndonjë titull tjetër; në nënfushën 200e është vendosur kur gjuhësisht ka qenë i lidhur me informacionin tjetër për titullin (emri i mbledhjes zakonisht është vendosur si përgjegjësi në nënfushën 200f).

⁴ Përshkrimi i të dhënave sipas renditjes që është në njësi nuk ka gjithmonë kuptim.

vendi dhe data e mbledhjes); emri i mbledhjes vendoset si titull kryesor në nënfushën 200a, vendi dhe data e mbledhjes vendosen si informacion tjetër për titullin në nënfushën 200e. Organizatori dhe redaktori janë në kolofon, i pari vendoset në nënfushën 200f, ndërsa i dyti në nënfushën 200g (të dhënat për përgjegjësinë në renditjen e njëjtë siç janë në njësi).

200 1_ aMjekimi kirurgjikal i infertilitetit
etakimi IX përkujtimor i Prof. dr. Nuredin Ibishi
ePrishtinë, 29 nëntor 2013
epërmbledhje punimesh
f[redaktor Maksut Bega, Rina Balaj]

(Në faqen e titullit është edhe e dhëna për mbledhjen dhe ajo për temën. Për titull kryesor është zgjedhur tema e takimit, e cila është e theksuar në mënyrë grafike (fusha 200a). Emri i takimit vendoset si informacioni tjetër i parë për titullin (nëntitull) në nënfushën e parë 200e (emri i takimit ndodhet mbi titullin, i shënuar me shkronja më të vogla). Të dhënat e tjera për titullin vendosen në atë renditje që kanë në faqen e titullit (fillimisht është vendi i mbledhjes, nën të data e mbledhjes, ndërsa poshtë është termi »përmbledhje punimesh«). Vendi dhe data e mbledhjes shënohen si informacion i përbashkët për titullin në nënfushën e dytë 200e, ndërsa termi »përmbledhje punimesh« shënohet si informacioni i fundit për titullin (nënfusha e tretë 200e). Redaktorët ndodhen në kolofon dhe vendosen në nënfushën 200f.

Katalogët

Kur katalogu i ekspozitës ka titullin e vet, ai vendoset në nënfushën 200a, emri i artistit vendoset si përgjegjësi në nënfushën 200f. Kur katalogu nuk ka titull, si titull vendoset emri i artistit (në këtë rast emri i tij nuk përsëritet tek të dhënat për përgjegjësinë).

Fusha 205 Botimi

Termi për botimin gjithmonë shënohet në gjuhën, në të cilën është njësia, dhe ai shkurtohet. Numri i botimit shënohet me numra arab dhe në përputhje me rregullat gramatikore të gjuhës, në të cilën është njësia (p.sh. *Bot. 1, 1st ed., 1. Aufl., 1a ed.* etj.). Termet për ribotimet dhe shprehjet e tjera (p.sh. botim i plotësuar, i zgjeruar, i përmirësuar) nuk shkurtohen, mirëpo nëse në njësi janë të shkurtuara (p.sh. *Bot. 2 i përmir.*), në të njëjtën mënyrë vendosen edhe në regjistrim.

Shprehja "First published" nuk është e dhënë për botimin dhe ajo nuk vendoset në përshkrim.

E dhëna për botimin vendoset në nënfushën 205a (p.sh. *Bot. 2*), të dhënat shtesë për botimin vendosen në nënfushën 205b (p.sh. **205aBot. 2 bRibot. 4**). Kur e dhëna shtesë për botimin është gjuhësisht e lidhur me të dhënë për botimin, ashtu vendoset edhe në regjistrim (p.sh. **205aRibot. 2 i bot. të 12 në gjuhën shqipe**).

Fusha 210 Botimi, prodhimi etj.

Në fushën 210a vendoset vendi i botimit, në nënfushën 210c emri i botuesit dhe/ose prodhuesit, në nënfushën 210d viti i botimit, në nënfushën 210e vendi i prodhimit dhe në nënfushën 210g emri i prodhuesit (shtypshkronjës).

Nënfusha 210a

E dhëna për vendin e botimit në nënfushën 210a duhet të jetë në harmoni me kodin në nënfushën 102a.

Vendi i botimit shënohet në formën dhe rasën, në të cilën është në njësi (p.sh. Prishtinë, në Tiranë).

Kur në njësi vendi i botimit nuk është i saktë, në kllapa katrore pas shkurtesës **i. e.** vendosni vendin e saktë (p.sh. *Prishtinë [i. e. Lipjan]*).

Kur botuesi e ka selinë në disa vende, secili vend vendoset në nënfushën e përsëritshme 210a. Nëse janë më shumë se tri vende, shënohet i pari dhe në kllapa katrore shënohet shkurtesa **etc.** (p.sh. *Shkodër [etc.]*).

Kur disa vende të botimit kanë emra të njëjtë, për ta bërë dallimin midis tyre, vendeve të botimit mund t'u shtoni emrin e krahinës ose shtetit. Shpjegimi shtesë shënohet në kllapa rrumbullake (apo në kllapa katrore nëse atë e vendosni ju) dhe në formën siç është në njësi (p.sh. *Cambridge (Mass)*).

Kur vendi i botimit në faqen e titullit apo në burimin e të dhënave është në disa gjuhë, formën paralele mund ta shënoni pas shenjës së barazimit dhe hapësirës në nënfushën e përsëritshme 210a (p.sh. **210a***Celovec a= Klagenfurt*).

Kur vendi i botimit nuk është në njësi, mirëpo ju e dini ose e gjeni dikund tjetër, atë e shënoni në kllapa katrore (p.sh. *[Ferizaj]*). Nëse të dhënë për vendin e botimit nuk mund ta gjeni askund, në kllapa katrore vendosni hapësirën e gjerë gjeografike (p.sh. *[Argjentina]*). Nëse as kjo nuk është e mundur, në kllapa katrore vendosni shkurtesën **s. l.** (*[S. l.]*).

Nënfusha 210c

Emri i botuesit vendoset pas vendit, në të cilin e ka selinë. Përparësi ka forma nga faqja e titullit. Emri i botuesit vendoset në rasën emërore. Termat e përgjithshëm për botuesin nuk shënohen (p.sh. Verlag, Publishers, Casa Editrice), përveç nëse ata janë të lidhur gjuhësisht me emrin; gjithashtu nuk shënohen shkurtesat për statusin juridik të botuesit (p.sh. Inc, d.d., GmbH, Ltd.).

Kur në fund të emrit të botuesit është vendi, në të cilin botuesi e ka selinë, vendi shënohet në nënfushën 210a, nërsa në emrin e botuesit në nënfushën 210c ai nuk përsëritet (p.sh. **210a***Balaj cShkolla Fillore*). Kur vendi dhe emri i botuesit janë të lidhur gjuhësisht mes vete, vendi i botimit në nënfushën 210c vendoset (p.sh. *Ljubljanske mlekarne (Qumështoret e Lubjanës), Oxford University Press*).

Emri vetjak i botuesit individual (themeluesit/pronarit të shtëpisë botuese) ose vetëbotuesit vendoset duke shënuar shkronjën e parë të emrit dhe mbiemrin (p.sh. *K. Page*). Shkronja e parë e emrit nuk vendoset brenda shenjave për klasifikim. Botues individual është edhe autori i disertacionit të doktoratës, tezës së masterit dhe punimit të diplomës. Kur autori i veprës shfaqet si vetëbotues, në nënfushën 210c shënohet shkurtesa **vetëbot**.

Shënohen më së shumti tre botues. Kur janë më shumë se tre botues, vendoset i pari dhe në kllapa katrore shënohet shkurtesa **etc.** (p.sh. *Toena [etc]*).

Kur botuesi në faqen e titullit apo në burimin e të dhënave është në disa gjuhë, forma paralele mund të shënohet pas shenjës së barazimit dhe hapësirës në nënfushën e përsëritshme 210c (p.sh. **210c***Mohorjeva c= Hermagoras*).

Kur në njësi janë disa botues, të cilët e kanë selinë në vende të ndryshme, emri i botuesit vendoset pas vendit, në të cilin e ka selinë (p.sh. **210a***Prishtinë cRilindja aFerizaj cFerPress*).

Kur në botim është vetëm shtypshkronja (shpesh funksionet e botuesit dhe të shtypshkronjës janë të bashkuara), në nënfushën 210c vendoset emri ishtypshkronjës si botues.

Kur botuesi nuk është në njësi, mirëpo e gjeni në ndonjë burim tjetër të të dhënave, atë e vendosni në kllapa katrore (p.sh. [*Shoqata e Ekonomistëve të Shqipërisë*]). Nëse të dhënë për botuesin nuk e gjeni askund duhet të shënoni shkurtësën **s. n.** (*[s. n.]*).

Nënfusha 210d

E dhëna për vitin e botimit në nënfushën 210d duhet të jetë në harmoni me vitin dhe kodin për vitin e botimit në nënfushat 100bcd.

Kur përveç vitit janë të dhënat edhe për ditën dhe/ose muajin, ato nuk shënohen, përveç në rastet kur njësia është botuar disa herë brenda vitit të njëjtë kalendarik dhe e dhëna nevojitet për të bërë dallimin midis tyre.

Nëse viti i botimit në njësi është gabim, ai shënohet ashtu siç është në njësi, ndërsa në kllapa katrore vendoset viti i saktë (p.sh. *2003 [i. e. 2004]*). Kur në njësi janë disa vite të botimit, zakonisht si vit i botimit përzgjidhet viti më i ri. Gjithmonë merret viti i botimit nga faqja e titullit, të cilit sipas nevojës pas shpjegimit [**i. e.**] i shtoni edhe vitin e saktë nga kolofoni ose faqet e para (p.sh. *2000 [i. e.] 2001*), nga kapaku (p.sh. *2001 [i. e. 2002]*) ose nga ndonjë burim tjetër (p.sh. *1999 [i. e. 2000]*).

Kur në njësi ndodhet viti i botimit në formë dyshe (p.sh. *1999/2000*), duhet të gjendet viti i vërtetë i botimit (në nënfushën 210d mund të shënohet vetëm një vit). Në nënfushën 100c vendoset viti i vërtetë i botimit, ndërsa në nënfushën 100d viti tjetër. Në fushën 300 vendoset shpjegimi për vitin e botimit në formë dyshe (p.sh. *Në faqen e tit. viti i botimit 1999/2000*).

Kur në njësi nuk ndodhet viti i botimit/prodhimit, në vend të tij vendoset viti i shtypjes (pa shpjegim). Kur viti i shtypjes nuk dihet vendoset viti i copyright-it me shpjegim (p.sh. *cop. 2003*). Kur viti i copyright-it ndryshon shumë nga viti i botimit, mund t'i vendosni të dy vitet (p.sh. *2005, cop. 1984*). Kur dallimi midis viteve nuk është shumë i madh (p.sh. viti copyright-it 2003, viti i botimit 2005), mjafton shënimi vetëm i vitit të botimit.

Kur në njësi nuk ndodhet viti i botimit, duhet të përcaktohet periudha e përafërt e botimit dhe të vendoset brenda kllapave katrore, me shpjegimin përkatës (p.sh. [*midis 2001 dhe 2005*] ose [*ca. 1984*]). Pjesa e vitit, e cila nuk mund të përcaktohet, zëvendësohet me viza (vendoset vetëm dhjetëvjeçari ose qindvjeçari ose shekulli, p.sh. [*199-*] ose [*19--*]).

Kur ekziston mundësia, që njësia të jetë botuar në vitin e caktuar, mirëpo nuk mund të jeni të sigurt (p.sh. përmbledhje punimesh nga konferenca), në nënfushën 210d vitit në kllapa katrore i shtoni pikëpyetjen (p.sh. [2005?], ndërsa në nënfushën 100b vendosni kodin "d".

Kur njësia botohet në disa vëllime dhe vëllimet e veçanta janë të përshkruara në shënimet për përmbajtjen, në nënfushën 210d vendoset viti i botimit i vëllimit të parë dhe të fundit (p.sh. 2000-2006). Kur botimi ende nuk ka përfunduar ose nuk i keni të gjitha vëllimet, pas vitit në nënfushën 210d vendoset viza (p.sh. 2006-) ose viti tjetër vendoset brenda kllapave këndore (p.sh. 2000-<2002>). Kur pas vitit të botimit ndodhet viza, domethënë se vëllimet e botuara deri më tani kanë dalë brenda një viti (një vëllim ose disa), ndërsa viti i botimit në kllapa këndore domethënë se vëllimi i fundit nuk ka dalë ende apo nuk është i disponueshëm (në kllapa katrore vendoset viti i botimit i vëllimit të fundit të disponueshëm).

Kur viti i botimit nuk është në burimin e të dhënave (e dhëna është në kapak ose e keni gjetur dikund tjetër), ai vendoset në kllapa katrore.

Nënfushat 210e dhe 210g

Të dhënat për shtypjen vendosen vetëm kur të dhënat për botuesin dhe vetëbotuesin nuk janë të plota. Kur në njësi nuk ndodhet as emri i botuesit e as i shtypshkronjës, në fushën 210 vendoset vetëm e dhëna për vitin e botimit (p.sh. **210a**[S. l. cs. n.] **d2000 e**[s. l. gs. n.] ose **210a**[S. l. cs. n. **d2002?**] **e**[s. l. gs. n.]

Vendi i shtypjes vendoset në nënfushën 210e, ndërsa emri i shtypshkronjës në nënfushën 210g. Kur emri i shtypshkronjës përbëhet nga shprehja "shtypshkronja" dhe emri i vendit, shënohen të dyja (p.sh. [Prishtinë] : Shtypshkronja Prishtina).

Kur shtypshkronja ka emrin e një individi, i cili nuk është pronari, përdoret thonjëzat (edhe nëse në njësi ato nuk ndodhen), p.sh. "Naim Frashëri".

Fusha 215 Përshkrimi fizik

Në nënfushën 215a bëhet përcaktimi specifik i materialit dhe numri i faqeve, në nënfushën 215c hollësitë e tjera fizike, në nënfushën 215d përmasat dhe në nënfushën 215e materiali shoqërues (shtojca të palidhura me njësinë kryesore). Pë shkak të shfaqjes së saktë renditja e nënfushave duhet të jetë sipas radhës alfabetike – 215acde.

Të dhënat në nënfushat 215a dhe 215c duhet të jenë në harmoni me kodet në nënfushën (nënfushat) 105a.

Nënfusha 215a

Shënohet faqja e fundit e numërtuar (apo fleta) dhe shtohet shkurtesa përkatëse (p.sh. 231 f. ose 98 fl.). Kur faqet në njësi nuk janë të numërtuara ato numërohen dhe numri i tyre vendoset në kllapa

katrore. Kllapa katrore mbyllet pas numrit, ndërsa shkurtesa "f." shënohet jashtë kllapës (p.sh. [98]f.).

Numri i përgjithshëm i faqeve apo fletëve të shtojcave, të cilat nuk janë të përfshira në numërtimin kryesor (shtojcat e lidhura me njësinë kryesore), vendoset pas numërtimit kryesor dhe mes tyre ndahen me presje (p.sh. *XII, 184 f., 24 f. shtojcë*). Të dhënat duhet të jenë në harmoni me kodin në nënfushën 105a (kodi "f"). Kur shtojcat nuk janë të numërtuara, ato i numëroni dhe numrin e tyre e vendosni në kllapa katrore (p.sh. *295 f., [8] fl. shtojcë me ngjyra*).

Tek monografitë në disa vëllime, të cilat nuk kanë titullin e tyre (dhe nuk vendosen në shënimet për përmbajtjen në fushën 327) vendoset përcaktimi specifik i materialit (**vëll.**) dhe pas tij numri arab që tregon numrin e vëllimeve (p.sh. *2 vëll.*), ndërsa numri i faqeve vendoset në kllapa rrumbullake. Kur numërtimi në vëllimet e veçanta vazhdon nga njëri vëllim te tjetri, vendoset faqja e fundit e numërtuar e vëllimit të fundit (p.sh. *2 vëll. (398 f.)*). Midis numrit të faqeve të vëllimeve të veçanta vendoset pikëpresja (p.sh. *2 vëll (VI, 276; XII, 312 f.)*).

Kur njësia botohet në disa vëllime dhe vëllimet e veçanta janë vendosur në shënimet për përmbajtjen në fushën 327, në nënfushën 215a vendoset numri i vëllimeve të veçanta (numri i faqeve vendoset tek vëllimet e veçanta në fushën 327). Kur botimi është i përfunduar dhe biblioteka posedon të gjitha vëllimet, fillimisht vendoset numri i vëllimeve e më pas shkurtesa vëll. (p.sh. *7 vëll.*). Kur botimi ende nuk ka përfunduar apo biblioteka nuk i posedon të gjitha vëllimet, numri i vëllimeve vendoset në kllapa këndore (p.sh. *Vëll. <1-> ose Vëll. <1-3, 4, 6>*).

Nënfusha 215c

Në nënfushën 215c vendosen të dhënat për ilustrimet, fotografitë, grafikët, hartat, planet, tabelat, notat muzikore etj., të cilat janë pjesë e përmbajtjes së njësisë. Përdoret shprehja më e përshtatshme dhe ajo shkurtohet (p.sh. *fotogr.*). Mund të vendosen disa lloje të ilustrimeve (p.sh. *graf., harta ose me il., tabela*). Termi "me ilustrime" është më i përgjithshmi dhe mund të përdoret në vend të shprehjeve të tjera.

Kur në faqet e numërtuara ndodhet fotografia e autorit, në nënfushën 215c vendoset shprehja *fotogr. e autorit* apo *fotogr. e autores*. Kur fotografia e autorit ndodhet në shtojcën e lidhur me njësinë, e dhëna vendoset nënfushën 215a (p.sh. *193 f., [1] fl. shtojcë me fotogr. e autorit*).

Nënfusha 215d

Në nënfushën 215d vendoset gjatësia e shpinës së librit në cm. Përkrah gjatësisë vendoset edhe gjerësia kur kjo e fundit e kalon gjatësinë (p.sh. *25 x 28 cm*).

Nënfusha 215e

Shtojcat e palidhura me njësinë apo materialet shoqëruese, të cilat nuk kanë titullin e tyre, vendosen në nënfushën 215e (p.sh. *1CD ose manual (205 f. ; 15 cm)*).

(Kur materiali shoqërues ka titullin e tij dhe kur të dhënat në materialin shoqërues ndryshojnë nga të dhënat në njësinë kryesore, ai vendoset në fushën 421.)

Fusha 225 Seria

Në nënfushën 225a vendoset titulli kryesor i serisë, në nënfushën 225d titulli paralel i serisë, në nënfushën 225e informacioni tjetër për titullin e serisë (nëntitulli), në nënfushën 225f përgjegjësia për serinë, në nënfushën 225x ISSN e serisë dhe në nënfushën 225v numërtimi në kuadër të serisë.

Vlera e treguesit në fushën 225 gjithmonë është "1".

Kur në njësi ndodhet titulli i plotë i serisë dhe akronimi i tij, njërën nga format e përzgjidhni për titullin e serisë (nënfusha 225a), ndërsa tjetrën për nëntitullin e serisë (nënfusha 225e).

Termet e përgjithshëm për serinë, nënserinë (nëse nuk janë gjuhësisht të lidhura me titullin) vendosen brenda thonjzave (p.sh. *≠Seria ≠Shekulli XX*, mirëpo nëse janë gjuhësisht të lidhura *Seria e librave për fëmijë*).

Kur titull i serisë është një term i përgjithshëm ose titull të njëjtë të serisë kanë botues të ndryshëm, në të dhënat për përgjegjësinë pas titullit të serisë (nënfusha 225a) në nënfushën 225f vendoset botuesi. Redaktori i serisë nuk vendoset.

Kur seria ka ISSN ajo vendoset në nënfushën 225x para të dhënës për numërtimin në nënfushën 225v.

Shkurtesa për vëllimin në nënfushën 225v shënohet me shkronjë të vogël në përputhje me rregullat gramatikore të gjuhës së njësisë dhe brenda shenjave për klasifikim. Numërtimi vendoset me numra arab. Termi për vëllimin, numrin etj. vendoset para numrit dhe shkurtohet (p.sh. *≠vëll. ≠3* ose *≠Bd. ≠5*). Kur vendoset numërtimi i disa vëllimeve, të gjitha të dhënat vendosen në një nënfushë 225v, ndërsa mes vete ndahen me pikëpresje (p.sh. *≠vëll. ≠31; 32*).

Si numërtim në seri nuk konsiderohet numërtimi i botuesit (nga numërtimi i serisë dallohet sepse zakonisht është numër i madh).

BLLOKU 3XX

Shënimet bëhen në gjuhën e katalogimit (në rastin tuaj në gjuhën shqipe). Në fund të shënimeve nuk vendoset pika.

Në bllokun 3XX nuk përdoren shenjat për klasifikim, sepse fushat e caktuara nuk janë të indeksuara.

Te shënimi i numrit të faqeve për parathëniet, tekstet shtesë, bibliografitë etj., (numri i faqeve që nuk janë të përfshira në numrin e përgjithshëm të faqeve në nënfushën 215a) përdoren kllapat katrore (p.sh. *Parathënie / Zhaklina Zefi: f. 210-[214]* (njësia ka 213 faqe të numërtuara)). Kur faqja nuk është e numërtuar, mirëpo është e përfshirë në numrin e përgjithshëm të faqeve në nënfushën 215a, kllapat katrore nuk përdoren (p.sh. *Bibliografia: f. 6*).

Kur faqet në njësi nuk janë të numërtuara (në nënfushën 215a numri i faqeve është në kllapa katrore), tek shënimi i faqeve të tekstit shtesë nuk përdoren kllapat katrore (p.sh. **215a**[78] f. **300a***Rreth autorit: f. 76-78*).

Fusha 300 Shënimi i përgjithshëm

Kur në njësi ndodhet edhe titulli origjinal, shënimi për titullin e origjinalit është i detyrueshëm (e dhëna vendoset edhe në fushën 500) përdoret fraza hyrëse Tit. i origj. Nëse e dhëna për titullin e origjinalit nuk është në njësi, mirëpo atë e gjeni në ndonjë burim jashtë saj, përdoret fraza Tit. i saktë i origj.

Në shënimet për veprën e përkthyer vendoset titulli i origjinalit, ndërsa nëntitulli i origjinalit zakonisht vendoset kur në përkthimin, i cili katalogohet, nëntitulli nuk është përkthyer ose ndryshon shumë nga nëntitulli i origjinalit.

Kur njësia nuk është përkthyer nga origjinali, titulli i tekstit të ndërmjetëm dhe i origjinalit vendosen brenda një shënimi (Tit. i origj.: ...; Tit. i saktë i origj.: ...), para pikëpresjes nuk ka hapësirë.

Në shënime variantet e titujve vendosen pas frazës përkatëse hyrëse (*Tit. në kapak: ... ose Tit. në shpinë: ... ose Tit. në koloфон: ...* etj.). Si element për kërkim variantet e titujve vendosen në fushën përkatëse në bllokun 5XX.

Kur në njësi nuk ka faqe të brendshme të titullit dhe si faqe zëvendësuese trajtohet kapaku, përdoret shënimi *Tit. i kapakut* (faza hyrëse *Tit. në kapak* përdoret kur titulli në kapak dallon nga titulli në faqen e brendshme të titullit, që është burimi kryesor i të dhënave).

Kur informacionin tjetër për titullin (nëntitullin) nuk e gjeni në burimin e të dhënave, atë në nënfushën 200e e vendosni në kllapa katrore, ndërsa në fushën 300 vendosni shënimin se në cilën pjesë të njësisë e keni gjetur (*Informacioni tjetër për tit. në kapak / në shpinën e faqes së tit. / në koloфон*). Rregulla vlenë edhe për titullin kryesor dhe titullin e pjesës.

Kur informacioni tjetër për titullin (nëntitulli) në kapak (ose në ndonjë burim tjetër të të dhënave) dallon nga informacioni tjetër për titullin (nëntitulli) në burimin kryesor të të dhënave, ai vendoset në zonën e shënimeve pas frazës hyrëse përkatëse (p.sh. *Informacioni tjetër për tit. në kapak: ...*). Ai mund të vendoset edhe si element kërkimi në fushën 540.

Kur emri i autorit parësor nuk (emër vetjak ose i organizatës) nuk ndodhet në burimin kryesor të të dhënave dhe në nënfushën 200f është i vendosur në kllapa katrore, në shënimet në fushën 300 vendosni shpjegimin se në cilën pjesë të njësisë e keni gjetur (p.sh. *Autori në kapak ose autori kolektiv në shpinën e faqes së tit.*).

Kur në fushat 200 dhe 205 (zona 1 dhe 2 në ISBD) vendosen të dhënat e marra nga CIP-i, duhet të bëhet shënim (p.sh. Përkthyesi në CIP ose E dhëna për bot. në CIP).

Kur teksti në njësi është në gjuhë të ndryshme, e dhëna vendoset si shënim i përgjithshëm. Kur teksti në njësi është vetëm në një gjuhë, shënimi për gjuhën e tekstit nuk bëhet. Shënimi për gjuhën është mirë të bëhet edhe në rastet kur teksti është vetëm në një gjuhë, mirëpo titulli i saktë (kryesor) është

në dy ose disa gjuhë. Në krijimin e këtyre shënimeve përdoren shkurtesat (p.sh. *Teksti në gjuhën shqipe dhe përkthimi në gjuhën angl. ose Teksti paralel në gjuhën shqipe dhe it.*). Të dhënat për gjuhën e tekstit duhet të jenë në harmoni me kodin (kodet) në nënfushën (nënfushat) 101a.

Tek të dhënat për numrin e kopjeve mijëshet ndahen me presje (p.sh. *Tirazhi 1.500*).

Parathëniet, tekstet shtesë etj. vendosen në fushën 300 sipas kësaj skeme: Titulli / autorësia: f. xx-yy. Shënimi për tekstet shtesë bëhet në rastet kur autori i tyre nuk është edhe autor i veprës.

Në shënime të dhënat citohen në formën e përcaktuar. Teksti i cituar vendoset në thonjëza, kur nuk shënohet e gjithë fjalia përdoren tri pikat, ndërsa pas citatit vendosen dy viza dhe shigjeta e më pas burimi (p.sh. "... tryeza e 3-të bankare, të cilën e ka organizuar Shoqata e Ekonomistëve të Shqipërisë më 10 shkurt 2001 në Tiranë." --> f. 5).

Në fushën 300 vendoset edhe lloji i shkrimit jolatin (p.sh. *Cir.*), ndërsa e dhëna duhet të përputhet me kodet në nënfushat 100gil. Në shënime vendoset edhe teksti për shkrimin gotik (*Got.*), mirëpo për shkak se nuk bëhet fjalë për regjistrim të modifikuar, kodi në nënfushën 100g nuk vendoset.

Fusha 314 Shënimi për përgjegjësinë intelektuale

Autorët që nuk ndodhen në burimin kryesor të të dhënave dhe autorët, të cilët në përputhje me rregullat e katalogimit nuk shënohen në zonën e përgjegjësisë, mund të vendosen në shënime në fushën 314 (p.sh. këshilluesit e disertacioneve të doktoratave, tezave të masterit apo punimeve të diplomës).

Fusha 320 Shënimi për bibliografitë/indekset/përmbledhjet brenda burimit

Literatura vendoset me termin Bibliografia dhe numrin e faqeve, në të cilat ndodhet (p.sh. *Bibliogr.: f. 120-130 ose Bibliografia te secili kapitull*). Sipas praktikës së bibliotekave shqiptare termi Bibliografia shkurtohet në Bibliogr. kur pasohet nga numri i faqeve. Nëse termi për bibliografinë në njësi është më i hollësishëm ai citohet (p.sh. *Selected bibliography: f. 215-231*). Shënohet edhe titulli i bibliografisë së autorit të veprës që katalogohet (p.sh. *Bibliogr. e Kadaresë: f. 197-203*) ose titulli i bibliografisë së personit për të cilin flet vepra. Midis vizës dhe numrit të faqeve nuk duhet të ketë hapësirë.

Për të gjitha llojet e indekseve (indeksit të emrave etj.) përdoret termi i përgjithshëm indeks, pa numrin e faqeve (Indeks, Indekse). Përmbajtja nuk vendoset si indeks. E dhëna për indeksin kodohet në nënfushën 105e.

Përmbledhja (abstrakti) vendoset pa numrin e faqeve. Nëse përmbledhja (abstrakti) ka titull, ai shënohet. Shënimi për përmbledhjen (abstraktin) vendoset në rastin kur është në gjuhën e njësisë. Midis shënimeve për përmbledhjen në gjuhë të ndryshme vendoset hapësirë, pikëpresje, hapësirë (p.sh. *Përmbledhje ; Summary ; Zusammenfassung*). Gjuha e përmbledhjes (abstraktit) kodohet në nënfushën 101d.

Tek përmbledhjet e punimeve (p.sh. materialet nga kongreset) të dhënat për abstraktet dhe bibliografitë bashkohen në një shënim (p.sh. *Bibliografia dhe summary tek shumica e punimeve*). Për përmbledhjen (abstraktin) përdoret termi nga njësia, mirëpo nese përdoret termi në gjuhën shqipe, duhet të vendoset gjuha e përmbledhjes (abstraktit) (*Bibliografia tek të gjitha punimet, përmbledhja në gjuhën angleze tek shumica e punimeve*).

Fusha 324 Shënimi për originalin

Tek faksimilet, botimet e veçanta etj., në fushën 324 vendoset shënimi për originalin – vendi, emri i botuesit dhe viti i botimit të versionit origjinal (p.sh. *Bot. i origj.: Tiranë : A. Bregu, 1947*)

Fusha 327 Shënimi për përmbajtjen

Kur përshkruhet përmbajtja e botimit në tërësi vlera e treguesit të parë është "1", ndërsa kur vendoset vetëm një pjesë e përmbajtjes vlera e treguesit të parë është "0".

Nënfusha 3270

Në nënfushën 3270 përmes frazës hyrëse shpjegohet nëse është përshkruar përmbajtja në tërësi (*Përmbajtja*) apo vetëm një pjesë e saj (*Nga përmbajtja*). Kur përmbajtja e botimit është në faqen e titullit, si frazë hyrëse përdoret *Përmbajtja në f. e tit.* Kur botimi përmban p.sh. vepër të fshehur (e dhëna për të nuk ndodhet në faqen e titullit), si frazë hyrëse përdoret *Përmban edhe*.

Kur një pjesë e botimit është e shtypur në drejtim të kundërt, mund të përdoret fraza hyrëse *Përmban edhe tekst të shtypur në drejtim të kundërt* apo *Përmban edhe përkthim të shtypur në drejtim të kundërt*.

Kur njësia botohet në disa vëllime, në nënfushën 3270 përmes frazës hyrëse shpjegohen ose përshkruhen të gjitha vëllimet e veçanta (*Përmbajtja*) ose vetëm vëllimi i parë apo disa vëllime (*Përmbajtja e deritanishme*). Kur përshkruhen të gjitha vëllimet, vlera e treguesve është "11", ndërsa nëse biblioteka nuk i ka të gjitha vëllimet apo ato ende nuk janë botuar, vlera e treguesve është "01". Nëse vlera e treguesit të dytë është "1" të dhënat për vëllimet e veçanta shfaqen në një rresht të ri.

Pas frazës hyrëse vendosen dy pika (dy pikat në këtë rast nuk janë shenjë pikësimi që ndanë elementet e ISBD-së, për këtë arsye duhet të vendosen në mënyrë manuale).

Nënfusha 327a

Kur në këtë fushë vendoset përmbajtja e njësisë, e cila ka disa vepra të disa autorëve parësorë (në fushën 200 ndodhet titulli i përbashkët), titujt e veçantë dhe përgjegjësitë përkatëse vendosen në një fushë 327a. Kur në fushën 327 vendoset përmbajtja e njësisë, e cila ka disa vepra të një autori parësor, secili titull vendoset në një nënfushë 327a.

Kur në fushën 327 vendosen titujt e veprave të veçanta nga njësia, ata si element për kërkim vendosen edhe në fushën 423.

Kur njësia botohet në disa vëllime dhe vëllimet e veçanta nuk kanë titullin e tyre, vëllimet e veçanta përshkruhen në fushën 327 (kur titujt e vëllimeve të veçanta shprehin renditje të caktuar (alfabetike, periudhë kohore), p.sh. leksikonët, enciklopeditë etj.).

Fusha 328 Shënimi për disertacionin (tezën)

Në regjistrimet për disertacionet, tezat dhe punimet e diplomave në shënime vendoset institucioni, i cili e ka ndarë gradën. Kur e dhëna për disertacionin, tezën apo punimin e diplomës ndodhet në faqen e titullit dhe si rezultat i kësaj në nënfushën 200e, e dhëna nuk përsëritet edhe në fushën 328. Kur në fushën 200 nuk është shpjegimi se bëhet fjalë për disertacion doktorate, tezë masteri apo punim diplome, ai bëhet në fillim të shënimeve (p.sh. *Punim diplome, Univ. i Prishtinës, Fakulteti Filologjik*).

Në fushën 328 nuk vendosen këshilluesit (mentorët) e disertacioneve, tezave apo punimeve të diplomës (ata mund të vendosen në fushën 314).

BLLOKU 4XX

Te përpunimi i monografive përdoren fushat për lidhje 421 dhe 423. Të dyja fushat janë të fiksueshme, çfarë do të thotë se përmes nënfushës 1 fiksohen fushat e COMARC-ut. Nga lista e kodeve në nënfushën 4211 apo 4231 përzgjidhni fushën me treguesin përkatës. Vlerat e treguesve janë të njëjta sikurse në formatin kryesor.

Fusha 421 Shtojca

Fusha 421 përdoret për përshkrimin e materialit shoqërues, i cili ka titullin e tij. Në këtë fushë mund të fiksoni fushat e caktuara COMARC, të cilat janë të nevojshme për përshkrimin e materialit shoqërues (titulli, përgjegjësia, viti, përshkrimi fizik etj.) – domethënë fushat e caktuara nga blloku 2XX dhe 3XX. Fushat e tjera (blloku 0XX, 1XX etj.) nuk fiksohen. Nëse materiali shoqërues është në mjedis tjetër nga njësia kryesore, fiksohet nënfusha 200b, ndërsa kodi për formën e tij fizike vendoset tek të dhënat lokale (99Xg\o). Në skedë (shfaqja sipas ISBD-së) të dhënat nga fusha 421 shfaqen pas dy vizave nën shënimet.

(Kur materiali shoqërues përshkruhet në nënfushën 215e, fusha 421 nuk plotësohet.)

Fusha 423 Vepra e shtuar, e fshehur dhe e përfshirë

Në fushën 423 fiksohet titulli, i cili në përshkrimin kryesor është vendosur në nënfushën 200c, dhe pikëqasjet për autorët vetjakë ose kolektivë (organizatat apo mbledhjet), të cilat në përshkrimin kryesor janë të vendosura tek përgjegjësia (nënfusha 200f), si dhe titujt dhe pikëqasjet për autorët parësorë, të cilët në përshkrimin kryesor janë vendosur në shënimet për përmbajtjen (fusha 327). Përmes fiksimit mundësohet kërkimi me parashitesat TI, AU, CB dhe ndërtimi i përshkrimeve shtesë analitike (autor: titull), kur kjo është e nevojshme. Në fushën 423 fiksohen fushat: 200, 500, 503, 700, 701, 702, 710, 711, 712, 900, 901, 902, 910, 911 dhe 912.

Kur fiksohen disa vepra të një autori (titujt e veprave të veçanta janë të vendosur në nënfushat e përsëritshme 327a), te fusha e fiksuar 200 në fushën 423 përsëritet nënfusha **a** (p.sh. **423 _12000_ aHakmarrja elektrike aUdhëtarët aMagjistaret 1700_1 aGegolli bSaimir 4070**). Nëse fiksohen veprat e autorëve të ndryshëm, përsëritet fusha 423.

Kur disa vepra të një autori vendosen në fushën 200 (nënfushat e përsëritshme 200a), titujt e veçantë nuk vendosen në fushën 423.

BLLOKU 5XX

Në bllokun 5XX vendosen variantet e titujve që shfaqen në botim, mirëpo nuk janë përzgjedhur si titull kryesor. Përveq se bëhet shënim në fushën 300, ata vendosen edhe në fushat përkatëse në bllokun 5XX (p.sh. varianti i titullit në kapak vendoset në fushën 512, varianti i titullit në shpinën e librit në fushën 516 etj.). Nyjet e caktuara vendosen brenda shenjave për klasifikim.

Fusha 500 Titulli uniform

Fusha 500 përdoret për shënimin e titujve uniform te veprat klasike anonime (p.sh. Bibla ose *Nibelungenlied*).

Për shkak të lidhjes së përkthimeve me veprat origjinale fusha 500 përdoret edhe për shënimin e titujve origjinalë. Në nënfushën 500m vendoset gjuha e njësisë, në këtë rast gjuha e përkthimit (p.sh. **500aElephants can remember mgjuha shqipe**). Vlera e treguesve është "00".

Kur në fushën 200 ndodhet titulli i përbashkët, numri i pjesës dhe titulli i pjesës (200ahi), e njëjta strukturë përdoret edhe në fushën 500, domethënë nënfushat 500ahi (p.sh. **500aÀ la recherche du temps perdu h7 iLe †temps retrouvé**).

(Titulli origjinal i veprës vendoset edhe në fushën 300 (shënimi i parë i detyrueshëm sipas ISBD-së).)

Fusha 503 Nënemërtimi formal

Për aktet ligjore dhe nënligjore të njësive politike e territoriale (p.sh. kushtetuta, ligjet, rregulloret etj.) përdoret pikëqasja që përbëhet nga emri i njësisë dhe nënemërtimi formal, i cili tregon llojin e aktit ligjor. Nënemërtimi formal shënohet në gjuhën e katalogimit.

Në nënfushën 503a formohet nënemërtimi formal (p.sh. Ligjet etj., Kushtetuta), e cila shfaqet pas emrit të njësisë politike e territoriale të vendosur në nënfushën 710a (p.sh. Shqipëria. Ligjet etj.).

Fusha 510 Titulli i saktë paralel

Në fushën 510 vendoset titulli i saktë paralel në rastet kur nevojitet përshkrimi shtesë (titulli paralel si element për kërkim është vendosur në nënfushën 200d). Fusha është e plotësuar në regjistrimet që për pikëqasje kanë titullin, ndërsa tek regjistrimet që për pikëqasje kanë autorin në rastet kur në fushën 200 vlera e treguesit është "1" (që do të thotë që për titullin duhet të bëhet patjetër përshkrim shtesë).

Fusha 532 Titulli i zgjeruar⁵

Fusha 532 plotësohet kur përshkruhen me fjalë numrat ose shkurtesat (inicialet, shkurtesat, akronimet, simbolet etj.) në titullin e saktë, kudo që ato ndodhen. Titulli në fushën 532 shënohet në tërësi. Titujt e zgjeruar janë të kërkueshëm, ndërsa në disa raste zëvendësojnë titullin e saktë për klasifikim në listat e titujve të renditur sipas radhës alfabetike, p.sh. në indekset e bibliografive. Numrat përshkruhen me fjalë në gjuhën e titullit.

Vendosja e titullit në fushën 532 është i detyrueshëm në këto raste:

- kur pjesa e parë e titullit është numër (shembulli 1 dhe 2),
- kur në fillim të titullit të saktë para numrit ndodhet nyja (shembulli 3),
- kur në fillim të titullit të saktë ndodhet kombinimi i numrave dhe simboleve (shembulli 4 dhe 5)
- kur në titull është simboli, i cili ndikon në klasifikim, p.sh. simboli & (shembulli 6).

Titulli përdoret për klasifikim, vlera e treguesit të parë është "1".

Shembulli 1

200 0_ a100 receptat e nënës
532 11 aNjëqind receptat e nënës

Shembulli 2

200 1_ a20th century
econtinuities and ruptures
532 11 aTwentieth century

Shembulli 3

200 0_ a‡The ‡4th revolution
ehow is reshaping human reality

532 11 a‡The ‡fourth revolution
(Nëse para numrit në fillim të titullit ndodhet nyja, ajo duhet të shënohet (vendoset brenda shenjave për klasifikim).)

⁵ Pas vendimit të Komisionit për Katalogim në NUK (Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Sllovenisë) dhe pas përditësimit të manualit COMARC/B në prill të vitit 2020 në fushën 532 titulli shënohet në tërësi (më parë është shënuar vetëm numri ose simboli apo kombini i numrave dhe simboleve në fillim të titullit të saktë). Për këtë arsye titulli i zgjeruar nuk vendoset më në fushën 540.

Shembulli 4

200 1_ a100 + 5

ejeto shëndetshëm, që të jetosh më mirë

532 13 aNjëqind plus pesë

(Përveç numrit është përshkruar edhe simboli +, për këtë arsye vlera e treguesit të dytë është "3".)

Shembulli 5

2000 1_ a1 + 1 = 3 und andere Geschichten

532 13 aEins plus eins ist drei und andere Geschichten

Shembulli 6

200 1_ aHegel & the infinite

532 13 aHegel & the infinite

(Vlera e treguesit të dytë është »3« (është përshkruar simboli).)

Në fushën 532 shënohet edhe numri brenda titullit të saktë (shembulli 1 dhe 2) si dhe shkurtesat apo inicialet, në fillim apo në mes të titullit (shembujt 3, 4, 5 dhe 6), kur kataloguesi vlerëson se këto të dhëna janë nevojshme për përdoruesit e katalogut. Titulli i zgjeruar në raste të tilla përdoret vetëm për kërkim, vendosja e titullit nuk është e detyrueshme. Vlera e treguesit të parë është "0", sepse për klasifikim përdoret titulli, i cili ndodhet në nënfushën 200a.

Shembulli 1

200 0_ aNumri 1 si shumë dhe produkt i thyesave

532 01 aNumri një si shumë dhe produkt i thyesave

Shembulli 2

200 0 aMatematika për klasën e 1 të shkollës fillore

532 01 aMatematika për klasën e parë të shkollës fillore

Shembulli 3

200 0_ aDDR

eLand, Volk, Wirtschaft in Stichworten

532 00 aDeutsche Demokratische Republik

(Treguesi i dytë ka vlerën »0«, që domethënë është përshkruar akronimi.)

Shembulli 4

200 0_ aDr. Janez Bleiweis dhe nderi i tij

532 02 aDoktor Janez Bleiweis dhe nderi i tij

(Treguesi i dytë ka vlerën »2«, që domethënë është përshkruar shkurtesa.)

Shembulli 5

200 0_ aCat vs. Cat

ekeeping peace when you have more than one cat

532 02 aCat versus cat

Shembulli 6

- 200 0_ aShtëpia e znj. Mari
- 532 02 aShtëpia e zonjës Mari

Fusha 532 është e përsëritshme. Kur në titullin e saktë në rend të parë ndodhet numri, por titulli ka edhe shkurtesa (inicialet, akronimet, shkurtesat etj.), në fushën 532 vendoset titulli me numrin e përshkruar me fjalë, vlera e treguesit të parë është "1", sepse kjo formë e titullit përdoret për klasifikim. Në titullin në fushën e përsëritshme 532 përkrah numrit mund të shënohet edhe shkurtesa etj., nëse kataloguesi vlerëson se kjo është e nevojshme për përdoruesit e katalogut. Vlera e treguesit të parë është "0", sepse për klasifikim përdoret titulli në fushën 532.

Shembull

- 200 0_ a50 vjet KF Kastrioti
- 532 11 aPesëdhjetë vjet KF Kastrioti
- 532 01 aPesëdhjetë vjet të Klubit të Futbollit Kastrioti
(Vendosja e titullit të zgjeruar në fushën e parë 532 është e detyrueshme, titulli përdoret për klasifikim, për këtë arsye vlera e treguesit të parë është "1". Nëse treguesi i dytë e ka vlerën "1", domethënë që është përshkruar me fjalë numri. Në fushën e përsëritshme 532 mund të përshkruhet me fjalë edhe shkurtesa, titulli nuk përdoret për klasifikim, për këtë arsye vlera e treguesit të parë është "0").

Përkrah numrave dhe shkurtesave, të cilat ndodhen në titullin e saktë (në nënfushën e parë 200a), mund të përshkruhen edhe numrat dhe shkurtesat që ndodhen në titujt e tjerë, siç është titulli paralel, titulli i pjesës, informacioni tjetër për titullin, titujt e vëllimeve të tjera (nënfushat 200c dhe nënfusha e përsëritshme 200a), nëse kataloguesi e sheh të nevojshme për përdoruesit e katalogut. Në raste të tilla titulli i zgjeruar nuk përdoret për klasifikim dhe vlera e treguesit të parë gjithmonë është "0", sepse për klasifikim përdoret titulli nga nënfusha e parë 200a. Megjithatë, titujt e përshkruar (zgjeruar) janë të kërkueshëm.

Shembuj:

- 200 0_ aGjëegjëza
e100 + 1
- 532 03 aNjëqind plus një
(Informacioni tjetër për titullin mund të përshkruhet (zgjerohet) në fushën 532 (për kërkim), vlera e treguesit të parë është "0". Përveç numrave është përshkruar edhe simboli +, për këtë arsye vlera e treguesit të dytë është "3").

- 200 0_ a1000 fjalët e mia të para
dMy first 1000 words
- 532 01 aNjëmijë fjalët e mia të para
- 532 01 aMy first thousand words
(Vendosja e titullit të përshkruar në fushën e parë 532 nuk është e detyrueshme, titulli nuk përdoret për klasifikim, vlera e treguesit të parë është "0". Në fushën e përsëritshme

532 mund të përshkruhet edhe titulli paralel, vlera e treguesit të parë është gjithashtu "0". Në të dyja fushat vlera e treguesit të dytë është "1", që tregon numrat e përshkruar.)

200 0_ a50 vjet të basketbollit tonë
d50 anni della nostra pallacanestro
e[1965-2015]

532 11 aPesëdhjetë vjet të basketbollit tonë

532 01 aCinquanta anni della nostra pallacanestro

(Vendosja e titullit të përshkruar në fushën e parë 532 nuk është e detyrueshme, titulli përdoret për klasifikim, për këtë arsye vlera e treguesit të parë është "1". Në fushën e përsëritshme 532 mund të përshkruhet edhe titulli paralel, titulli nuk përdoret për klasifikim, për këtë arsye vlera e treguesit të parë është gjithashtu "0". Në të dyja fushat vlera e treguesit të dytë është "1", që tregon numrat e përshkruar.)

Fusha 540 Titulli shtesë i vënë nga kataloguesi

Fusha 540 përdoret për shënimin e titullit ose një pjese të titullit, që është i rëndësishëm për kërkim dhe nuk ndodhet në njësi. Në shumicën e rasteve përshkrimi shtesë nuk është i nevojshëm, për këtë arsye vlera e treguesit zakonisht është "0".

Në fushën 540 vendoset edhe titulli i mbledhjes, i cili në pikëqasjen për organizatën është i lidhur me termin e përgjithshëm për konferencën (kur tema e mbledhjes është në rasën emërore), p.sh. **200 0_ \$aKonferenca profesionale Shkolla e natës... 540 1_ \$aShkolla e natës.**

Në fushën 540 nuk shënohet titulli, i cili është vendosur si informacion tjetër për titullin (nëntitull) në nënfushën 200e ose si titull i pjesës në 200i (me parashtesën "ti" kërkohet për të dhënat në nënfushat 200acdehi dhe ato në fushat për variantet e titullit në bllokun 5XX).

Në fushën 540 nuk vendosen titujt origjinalë apo informacionet e tjera të titullit origjinal (nëntitullit origjinal).

BLLOKU 7XX dhe 9XX

Fushat 70X

Emrat e autorëve të vendosur në fushën 200 apo në bllokun 3XX, janë të indeksuar në fushën 700, 701 dhe 702. Në fushën 700 vendoset emri i autorit, në fushën e përsëritshme 701 vendosen autorët alternativë, ndërsa në fushën e përsëritshme 702 autorët dytësorë (përkthyesit, redaktorët, ilustruesit, fotografët, autorët e teksteve shtesë etj.). Secilit autor në nënfushën 70X4 i shtohet kodi i autorësisë.

Fushat 700, 701 dhe 702 plotësohen përmes bazë së njësuar CONOR, me të cilën lidhen përmes nënfushave 70X3. Duhet të jeni të kujdesshëm në variantet e emrit; nëse forma e emrit nga njësia e përshkruar ende nuk është në bazën CONOR, ajo duhet të shtohet në regjistrimin e njësuar.

Fusha 700 dhe 701

Kur për veprën janë përgjegjës deri në tre autorë (autorësia parësore), emri i autorit të parë vendoset në fushën 700, emri i autorit të dytë (dhe të tretë) në fushën (fushat) 701. Vlera e treguesit të parë është "1" (përshkrimi shtesë).

Kur për veprën janë përgjegjës katër autorë parësorë (ose më shumë), emrat e tyre vendosen në fushat 701, për autorin e parë bëhet përshkrim shtesë (domethënë vlera e treguesit të parë është "1"). Vendosja e emrit të autorit të parë në fushën 701 është i detyrueshëm, ndërsa vendosja e emrave të autorëve të tjerë varet nga nevojat e bibliotekave të veçanta (apo përdoruesve të katalogut). Kur në fushat 701 vendosen të gjithë autorët, përshkrim shtesë bëhet vetëm për autorin e parë, për autorët e tjerë në fushat 701 vlera e treguesit të parë është "0".

Fusha 702

Në Slloveni, në regjistrimet për botimet vendase, në bllokun 70X vendosen emrat e të gjithë autorëve dytësorë, të cilët janë shënuar në përshkrimin bibliografik (në fushën 200 dhe në bllokun 3XX). Në regjistrimet për botimet e huaja vendosja e autorëve dytësorë në bllokun 7XX nuk është e detyrueshme (për këtë vendos biblioteka), në përjashtim të atyre autorëve, për të cilët në përputhje me rregullat e katalogimit përshkrimi shtesë është i detyrueshëm (zakonisht për redaktorin e parë të përmbledhjeve të punimeve).

Secilit autorë në nënfushën 70X4 i shtohet kodi përkatës i llojit të autorësisë. Duhet të keni kujdes në kodin 010 (përshtatës), i cili përdoret për autorët e përshtatjeve për mjedisin tjetër (p.sh. përshtatja e romanit për film), nga viti 2009 edhe për autorët e tekstit të përshtatur në një tekst të ri (p.sh. për autorin e botimit të shkurtuar të një romani).

Në fushën 702 vlera e treguesit të parë zakonisht është "0", përveç në rastet kur në përputhje me rregullat e katalogimit përshkrimi shtesë është i detyrueshëm.

Përshkrimi shtesë bëhet për personin, i cili është pjesë e titullit të saktë tek veprat anonime, dhe për redaktorin e parë të përmbledhjes së punimeve, për të cilën përshkrimi kryesor bëhet me titullin e saktë ose me autorin kolektiv (domethënë pikëqasja është titulli ose autori kolektiv). Nëse vepra ka autor vetjak, për redaktorin e veprës nuk bëhet përshkrim shtesë (ai në fushën 200 dhe në fushën 702 vendoset vetëm në rastet kur ndodhet në faqen e titullit).

Kur pikëqasje është emri i artistit (p.sh. në regjistrimin për katalogun e ekspozitës), autori i tekstit vendoset në fushën 702. Kur autori i tekstit paraqitet në faqen e titullit si autor, shpjegimi përkatës në fushën 200 (nënfusha 200f ose 200g) vendoset në kllapa katrore (p.sh. [teksti] *Miran Bala*), ndërsa vlera e treguesit të parë në fushën 702 është "0".

Fushat 71X dhe 91X

Emrat e organizatave, të vendosur në fushën 200 apo në bllokun 3XX, janë të indeksuar në fushat 710, 711 dhe 712. Në fushën 710 vendoset emri i organizatës që bartë përgjegjësinë parësore për

njësinë, në fushën e përsëritshme 711 emri i organizatës që bartë përgjegjësinë alternative, ndërsa në fushën 712 emri i organizatës që bartë autorësinë dytësore.

Treguesi i parë në fushat 71X tregon nëse në nënfushën 71Xa ndodhet institucioni (organizata) apo mbledhja, ndërsa vlera e treguesit të dytë tregon formën e pikëqasjes. Kur në nënfushën 71Xa vendoset emri i organizatës, vlera e treguesit të parë gjithmonë është "0" (edhe kur në nënfushën 71Xb si nënëmërtim vendoset e dhëna për mbledhjen). Vlera e treguesit të dytë mund të jetë "1" vetëm kur bëhet fjalë për emrin e njësisë politike-territoriale, çfarë do të thotë se në nënfushën 71Xa ndodhet emri i shtetit, qytetit etj.

Fushat 71X mund t'i plotësoni përmes bazës së njësuar të të dhënave CONOR apo përmes nënfushave 71X3, nëse posedoni lejen për krijimin dhe redaktimin e pikëqasjeve për organizatën, ose në mënyrë manuale duke vendosur të dhënat në nënfushat e veçanta, nëse këtë leje nuk e posedoni. Në këtë rast duhet të keni kujdes në formën e emrit të organizatës; nëse forma e emrit të organizatës nga njësia që përshkruani ende nuk është në bazën CONOR, atë duhet ta shtoni në regjistrimin e njësuar, përkatësisht në fushën e duhur në bllokun 9XX.

Organizatave

Në nënfushën 71Xa vendoset emri i organizatës (institucionit) kryesore, në nënfushën 710b vendoset emri i organizatës së varur (shembulli 3), ndërsa në nënfushën 710c si cilësor vendoset selia e organizatës, që nuk është pjesë e emrit zyrtar të organizatës (shembulli 2). Vendi ose selia nuk i shtohet emrit të organizatave ndërkombëtare (shembulli 4).

Cilësorët, të cilët vendosen në nënfushën 71Xc, përmbajnë të dhëna shtesë, të nevojshme për shpjegim dhe/ose dallim. Këto të dhëna janë emrat gjeografikë, p.sh. selia e organizatës, viti apo vitet, shpjegimi për llojin e organizatës etj.

Shembulli 1

71X 02 aAkademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Shembulli 2

71X 02 aInstituti "Hasan Prishtina"
cPrishtinë

Shembulli 3

71X 02 aUniversiteti i Prishtinës
bFakulteti Filozofik

Shembulli 4

71X 02 aInternational Federation of Library Associations and Institutions

Kur emri zyrtar i organizatës përmban emër gjeografik dhe kjo formë e emrit shfaqet në njësi, emri gjeografik vendoset si pjesë e emrit të organizatës në pjesën kryesore të pikëqasjes së njësuar (në nënfushën a) dhe jo si cilësor⁶.

Shembuj

- 71X 02 aBiblioteka Publike e Gjakovës
- 71X 02 aShoqata e Bibliotekarëve të Shqipërisë
- 71X 02 aAgjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës
- 71X 02 aAkademia e Shkencave e Shqipërisë
- 71X 02 aUzina Metalurgjike e Shkodrës
- 71X 02 aUniversiteti i Tiranës
- 71X 02 aShkolla Filllore "Pavarësia" në Balaj

Nëse për institucionet ndërkombëtare⁷ në burimet bibliografike ose në listat zyrtare shfaqet emri në gjuhën shqipe, kjo formë e emrit përzgjidhet për formimin e pikëqasjes⁸.

Shembull

- 71X 02 aAgjencia Ndërkombëtare për Energji Atomike
- 91X 02 aInternational Atomic Energy Agency

Kur në fillim të emrit zyrtar të organizatës është një nyje dhe kjo formë e emrit shfaqet në njësinë që katalogohet, nyja nuk shënohet. Për formën e emrit të organizatës me nyje formohet varianti i pikëqasjes (shembulli 1). Kur nyja është pjesë e pandashme e emrit të organizatës (p.sh. pjesë e emrit të personit, pjesë e emrit gjeografik), ajo shënohet (shembulli 2).

Shembulli 1

- 71X 02 aLibrary Association of Ireland
- 91X 02 aThe Library Association of Ireland

Shembulli 2

- 71X 02 aLos Angeles Philharmonic Orchestra

Kur emri zyrtar i organizatës përmban numër dhe kjo formë e emrit shfaqet në njësinë që katalogohet, numri në pikëqasjen e njësuar vendoset në të njëjtën formë, me numër arab ose romak,

⁶ Deri në vitin 2017, kataloguesit në Slloveni, emrin gjeografik në fund të emrit të organizatës e kanë vendosur si cilësor në nënfushën 71Xc.

⁷ E njëjta gjë vlenë edhe për mbledhjet (konferencat) ndërkombëtare (për pikëqasje përzgjidhet emri i konferencës në gjuhën shqipe).

⁸ Deri në muajin shkurt të vitit 2020, kataloguesit në Slloveni, për pikëqasjen e njësuar për institucionin ndërkombëtar kanë përzgjedhur emrin në gjuhën sllovene vetëm në rastet kur gjuha sllovene ka qenë një nga gjuhët zyrtare të atij institucioni.

dhe ajo nuk përshkruhet me fjalë⁹. Rekomandohet, që për emrin e organizatës të krijohet varianti i pikëqasjes me numër të përshkruar me fjalë. Për emrin e organizatës, e cila përmban numër romak, rekomandohet formimi edhe i pikëqasjes me numër arab.

Shembull

- 71X 02 aShkolla e I-rë Fillore e Durrësit
- 91X 02 aShkolla e parë Fillore e Durrësit
- 91X 02 aShkolla e 1-rë Fillore e Durrësit

Emri i vendit apo emri gjeografik si cilësor në pikëqasjen e njësuar vendoset në gjuhën shqipe, nëse forma e tillë e emrit ekziston në burimet referuese. Nëse forma shqipe në këto burime nuk ekziston, emri gjeografik vendoset në gjuhën origjinale¹⁰

Shembull

- 71X 02 aLeopold Museum
- cVjenë

Organizata e varur

Emri i organizatës së varur si nënëmërtim vendoset në nënfushën 71Xb (p.sh. seksioni i shoqatës, departamenti i fakultetit etj.).

Në pikëqasjet e njësuara për fakultetet, të cilat veprojnë në kuadër të universiteteve, emri i fakultetit vendoset si pjesë e varur e universitetit¹¹. I njëjti rregull vlenë për shkollat e mesme, të larta ose shkollat e tjera, të cilat veprojnë në kuadër të qendrave shkollore.

Shembuj

- 71X 02 aUniversiteti i Prishtinës
- bFakulteti Filologjik

- 71X 02 aQendra e Shkollimit në Tiranë
- bShkolla e Mesme e Zejtarisë

Njësitë politike-territoriale

Njësitë politike-territoriale janë organizata, të cilat në zonën e caktuar kryejnë funksione zyrtare (shtetet, komunat (bashkitë) etj.). Pikëqasja për njësinë politike-territoriale është emri gjeografik (emri i shtetit, emri i qytetit etj.), i cili shënohet në gjuhën shqipe, nëse kjo formë e emrit ekziston në burimet referuese. Nëse forma e emrit në gjuhën shqipe nuk ekziston, emri gjeografike vendoset në gjuhën origjinale¹²

⁹ Deri në shkurt të vitit 2020, kataloguesit në Slloveni, numrin në pikëqasjen e njësuar e kanë përshkruar me fjalë.

¹⁰ Deri në shkurt të vitit 2020, kataloguesit në Slloveni, emrin gjeografik e kanë vendosur në formën origjinale.

¹¹ Deri në vitin 2017, kataloguesit në Slloveni nuk e kanë vendosur atë në pikëqasjen e njësuar (në nënfushën 71Xa është vendosur fakulteti)

¹² Deri në shkurt të vitit 2020, kataloguesit në Slloveni, emrin gjeografik e kanë vendosur në formën origjinale.

Shembuj

71X 01 aKosova

71X 01 aShqipëria

71X 01 aSllovenia

71X 01 aShtetet e Bashkuara të Amerikës

Pikëqasja për njësinë politike-territoriale dytësore, që vepron nën patronatin e shtetit, njësisë federale ose krahinës:

71X 01 aemri i njësisë politike-territoriale
cemri i shtetit (ose i njësisë federale, ose krahinës)
cilloji i njësisë politike-territoriale

Shembull

71X 01 aFerizaj
cKosovë
ckomuna

Pikëqasja për njësinë politike-territoriale dytësore, që nuk vepron direkt nën patronatin e shtetit, njësisë federale ose krahinës:

71X 01 aemri i njësisë politike-territoriale
cemri i njësisë politike-territoriale kryesore, emri i shtetit (ose i njësisë federale, ose krahinës)
cilloji i njësisë politike-territoriale

Shembull

71X 01 aKatarina
cMedvode, Slloveni
cbashkësia lokale

Organizatrat e varura nga njësitë politike-territoriale

Emri i organizatës së varur nga njësia politike-territoriale vendoset në nënfushën 71Xb (organi i njësisë politike-territoriale etj.).

Shembuj

71X 01 aRepublika e Shqipërisë
bMinistria e Kulturës

71X 01 aPrizren
cRepublika e Kosovës

ckomuna
bKuvendi komunal

Mbledhjet apo konferencat

Në nënfushën 71Xa vendoset emri i mbledhjes ose organizatës kryesore (në rast të mbledhjes së organizatës së varur), në nënfushën 71Xb emri i organizatës së varur (në rast të mbledhjes së organizatës së varur), në nënfushën 710d numri rendor i mbledhjes, në nënfushën 71Xf viti i mbledhjes dhe në nënfushën 71Xe vendi i mbledhjes.

Numri rendor i mbledhjes në nënfushën 710d shënohet me numra arab.

Pikëqasjet formohen për mbledhjet që përmbajnë terma të përgjithshëm për llojin e grupit apo ngjarjes, siç është mbledhja, konferenca, ngjarja, festivali, simpoziumi, kongresi, takimi, ekspozita etj.

Shembuj

71X 12 aKongresi Shqiptar për Rrugët dhe Trafikun
d6
f2002
eVlorë
(Termi për llojin e grupit është i lidhur me temën.)

71X 12 aKongresi i Punonjësve Pedagogjikë të Kosovës
f2000
ePejë
(Termi për llojin e grupit është i lidhur me të dhënë se kush është mbledhur.)

71X 12 aDitët e Naimit
f1995
eTiranë
(Termi për llojin e grupit është i lidhur me emrin e personit, sipas të cilit është emëruar mbledhja.)

71X 12 aShoqata e Bibliotekarëve të Shqipërisë
dKonferenca
d7
f2004
eTiranë
(Mbledhje e institucionit.)

Pikëqasja formohet edhe për mbledhjet, të cilat njihen nga emri dhe nuk përmbajnë termin e përgjithshëm për mbledhjen (kongresi, konferenca etj.)¹³.

Shembull

71X 12 aKapërcimi i ylberit

¹³ Deri në shkurt të vitit 2020 në raste të tilla përshkrimi është bërë me titull, domethënë pikëqasja është ndërtuar nga titulli.

cekspozitë
d13
f2017
eElbasan

Kur për mbledhjen ndërkombëtare në njësi shfaqet emri në gjuhën shqipe, kjo formë e emrit përzgjidhet për pikëqasjen e njësuar (emri i mbledhjes në gjuhën shqipe vendoset në fushën 71X, ndërsa emri i mbledhjes në gjuhët e tjera në fushën e përsëritshme 91X).

Vendi i mbledhjes në pikëqasjen e njësuar vendoset gjithmonë, edhe në rastet kur i njëjti vend është vendosur edhe si pjesë e emrit të mbledhjes, pjesë e emrit të organizatës ose si cilësor të emri i organizatës¹⁴.

Shembull

71X 02 aShkolla e Mesme e Mjekësisë në Ferizaj
bKatedra e Shkencave Bazë
bSimpozium
d2
f2011
eFerizaj

Në pikëqasjen për mbledhjen vendosen të gjitha vendet; në rast se numri i vendeve është shumë i madh, kataloguesi vendos vet nëse do të vendos të gjitha vendet apo zonën e gjërë gjeografike (krahinën, shtetin) ose vendin më të eksponuar¹⁵.

Shembull

71X 12 aDitët e Naimit
d16
f2004
eTiranë
eShkodër
eVlorë
eKorçë

Në pikëqasjet e njësuara për mbledhjet online në vend të vendit të ngjarjes vendoset termi »online«; si cilësor vendoset edhe kur termi për mbledhjen online është i përfshirë në emërtimin e mbledhjes. Në raste të tilla emrat gjeografikë (p.sh. qytetet, shtetet etj.) në pikëqasjet e njësuara nuk vendosen.

Shembull

71X 12 aKonferenca Automatizimi në Industri dhe Ekonomi
d6
f2009
eonline

¹⁴ Deri në shkurt të vitit 2020 kataloguesit në Slloveni nuk e kanë vendosur vendin e mbledhjes, nëse i njëjti vend është pjesë e emrit të organizatës ose si cilësor në emrin e organizatës.

¹⁵ Deri në shkurt të vitit 2020 kataloguesit në Slloveni kanë vendosur më së shumti tri vende. Nëse kanë qenë më shumë se tri vende, është shtuar vendosur i pari dhe është shtuar shkurtesa etc.

Fushat 710 dhe 711¹⁶

Organizata vendoset në fushën 710 kur përmbajtja e botimit prezanton veprimtarinë dhe organizimin e një institucioni apo organizate. Kur botimi prezanton veprimtarinë e dy apo tri organizatave, emri i organizatës së dytë (dhe të tretë) vendoset në fushën (fushat) 711. Kur botimi prezanton veprimtarinë e katër ose më shumë organizatave, emri i organizatës së parë vendoset në fushën 711, ndërsa emrat e organizatave të tjera vendosen nëse kataloguesi vlerëson se kjo është e nevojshme për përdoruesit e katalogut. (Kur bëhet fjalë për monografi analitike apo studim, përshkrimi kryesor bëhet me autorin parësor apo me titull, ndërsa emri i organizatës vendoset në fushën 712.)

Në fushën 710 vendoset edhe emri i mbledhjes (për mbledhjen e emërtuar) kur botimi përmban materialet e mbledhjes. Kur botimi përmban materialet e dy apo tri mbledhjeve, emri i mbledhjes së dytë (dhe të tretë) vendoset në fushën (fushat) 711. Kur botimi përmban materialet e katër apo më shumë mbledhjeve, emri i mbledhjes së parë vendoset në fushën 711, ndërsa emrat e mbledhjeve të tjera vendosen nëse kataloguesi vlerëson se kjo është e nevojshme për përdoruesit e katalogut.

Fusha 712¹⁷

Në fushën 712 zakonisht vendoset organizatori i mbledhjes. Emri i botuesit asnjëherë nuk duhet të vendoset në këtë fushë (e dhëna për të vendoset në nënfushën 210c).

Kur emri i mbledhjes nuk ndodhet në burimin e të dhënave, mirë shfaqet vetëm brenda tekstit (p.sh. në hyrje ose parathënie), ai nuk vendoset në fushën 710, mirëpo si element për kërkim vendoset në fushën 712 (e dhëna në formën e citatit vendoset edhe në shënime në fushën 300).

Fusha 910, 911, 912¹⁸

Në fushat 910, 911 dhe 912 vendosen variantet e emrit të organizatës dhe mbledhjes, të cilat shfaqen në botim por nuk janë përzgjedhura për pikëqasjen e njësuar (forma e përkthyer e emrit të organizatës ose mbledhjes, shkurtesa etj.).

Shembuj

- 71X 02 aBiblioteka Kombëtare e Shqipërisë
cTiranë
- 91X 02 aBKSH
cTiranë
- 91X 02 aNational Library of Albania
cTirana

¹⁶ Të dhënat në fushat 710 dhe 711 në regjistrimin bibliografik korrespondojnë me të dhënat në fushën 210 në regjistrimin e njësuar.

¹⁷ Të dhënat në fushat 712 në regjistrimin bibliografik korrespondojnë me të dhënat në fushën 210 në regjistrimin e njësuar.

¹⁸ Të dhënat në fushat 910, 911 dhe 912 në regjistrimin bibliografik korrespondojnë me të dhënat në fushën 410 në regjistrimin e njësuar. Fushat 910, 911 dhe 912 plotësohen, nëse për organizatën ende nuk është krijuar regjistrimi i njësuar dhe nëse kataloguesi nuk posedon lejen për krijimin dhe redaktimin e pikëqasjeve për organizatën (përndryshe fushat – kur është e plotësuar nënfusha 71X3 – gjenerohen në mënyrë automatike nga baza e njësuar CONOR).

710 12 aSimpoziumi Ndërkombëtar Ndriçimi
d14
f2005
eGjilan

910 12 aInternational Symposium Lighting Engineering
d14
f2005
eGjilan

(Në fushën 910 duhet të vendosen të gjithë cilësorët, domethënë përsëritet numri rendor i mbledhjes, viti dhe vendi i mbledhjes. Për pikëqasjen e njësuar përzgjidhet emri i mbledhjes në gjuhën shqipe, ndërsa për emrin e mbledhjes në gjuhën angleze krijohet varianti i pikëqasjes.)

Përgatiti:
Irena Kavčič
Narodna in univerzitetna knjižnica

Redaktoi:
Suzana Šulek
Narodna in univerzitetna knjižnica

Përktheu në gjuhën shqipe dhe përshtati për kataloguesit në Shqipëri dhe Kosovë:
Arjeta Sadiku, Instituti i Shkencave të Informacionit – IZUM
Maribor, 14.12.2020